REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr._____Prot. Durrës, më ___.___.2025

**Lënda:** Raporti dhe informimi mbi veprimtarinë e Prefektit të Qarkut për muajt Janar-Dhjetor.

**MINISTRISË SË BRENDSHME**

**DREJTORISË SË ÇËSHTJEVE VENDORE DHE PREFEKTURAVE**

**TIRANË**

Në mbështetje të Ligjit Nr.107/2016 ”Për Prefektin e Qarkut” dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore që kanë të bëjnë me veprimtarinë e Prefektit téQarkut dhe në zbatim të Urdhërit të Ministrit të Brendshëm, Nr.667 datë 18.12.20148 "Për raportimin dhe informimin mbi veprimtarinë e Prefektit të Qarkut." po Ju dërgojmë raportin në lidhje me veprimtarinë e Prefektit të Qarkut Durrës për muajt Janar-Dhjetor 2024.

Gjatë këtij viti Prefekti i Qarkut Durrës ka organizuar punën duke u përqëndruar kryesisht në këto drejtime:

## I. Marrëdhëniet e Prefektittëqarkut me Administratën e Shtetërore:

**Takimetkryesoretërealizuaragjatëvitit 2024:**

**Mëdatë 18 .01 2024**PrefektiiQarkutDurrëszhvilloitakimin e parëkoordinuespërvitin 2024 të Task-ForcësNdërinstitucionalepërSezoninTuristikVeror 2024, kuishintëpranishëmdrejtuestëtëgjithainstitucionevepjesë e kësaj Task-Force.Takimikishtesiqëllimintensifikimin e masave, bashkërendimin e veprimtarisësëInstitucioneveShtetëroreligjzbatuese, DegëveTerritorialedheNjësivetëvetqëverisjesvendorepërmbarëvajtien e sezonittërituristikveror 2024. Nga ana e PrefektittëQarkutDurrës u kërkua me përparësidhevëmendje e veçantënëmirëorganizimin e planevetëpunës, duke vendosurtheksintekvendbazimettëcilatduhettëjenësipaskriterevetëpërshkruaranëligj. Kjovlenedhepërtëgjithamjetetlundruesedhesipërmarrësitprivattëcilëtshfrytëzojnëkëtovendbazimegjatë

periudhëssëverës, qënësezonin e ardhshëmduhet me çdokushttëpajisen me CERTIFIKATËN E OPERATORIT TURISTIK ngaMinistria e TurizmitdheMjedisitpërtëushtruarmë pas lirishtaktivitetin e tyreargëtuespërpushuesitnëtëkundërt do tëpezullohenngainstitucionetpërkatëse, ashtusiçndodhiedhenëzesonin e kaluarveror 2023. Duke marrëshkasngaproblematikat e dalagjatësezonitverortëkaluar u kërkuakoordinimndërinstitucionalipunësnëlidhje me plotësimin e detyrimevetëparashikuaranëligjmbimasatparaprakeqëduhettëmerrenngaBashkitëdheDegëtTërritoriale, përtëpaturnjësezonturistiktëmirëorganizuardhetësuksesshëm. Theksiveçantë u vendosAgjensiaRajonale e Mjedisitnëmirëmenaxhimin e ujëravetëzezangasubjektetqëushtrojnëveprimtarinë e tyreekonomikenëzonatbregdetare, liqenoredhelumenjve.
KjombështeturnëaktinnormativtëmiratuarngaKëshilliiMinistravedhebotuarnëFletorenZyrtaremëdatë 5 janar 2024, e cila ka tëbëjë me instalimin e impiantitpërtrajtimin e ujëravetëzezabrenda 3 muajvetëardhshëm, duke filluarnga data e botuarnëFletorenZyrtare. Ky aktnormativndalonpërfundimishtpërdorimin e gropaveseptike, nëtëkundërttëgjithasubjektettëcilatkapennëshkeljetëkëtijaktinormativ do tëgjobiten me masë administrative, qëvarijonnga 15 mijë euro derinë 26 mijë euro.  Pjesëmarrësit, diskutuanlidhur me detyratpërkatësetëcaktuarangaplaniimasave duke adresuarçështjetëndryshmeqëlidhen me sigurimin e vrojtuesvenëplazhe, krijimin e vendbregëzimevetëmjetevelundruese private, përcaktimin e zonavetësigurisësënotimit me bova (150 m ngabregu ), vendosjen e sinjalistikëssënevojshme, monitorimin, pastrimindhevendosjen e vrojtuesvenëplazhetpublikengaBashkiaDurrës, sidhemiratimin e disavendbazimevepërqytetarëtëndryshëmqëkërkojnëlundrimin me mjetet e tyre private nëdetë. Nëpërfundimpalëtshprehënangazhimin e tyretëplotëpërtëvijuarmëtejbashkëpuniminndërmjetinstitucioneve, me qëllimngritjen e kapacitetevenëofrimin e kushtevetësigurisë, qetësisëdhestandardevetëlartapërçdovizitordheturisttëhuaj e vendasnëvijënbregdetaretëQarkutDurrës.

**Mëdatë 18.01.2024**PrefektiiQarkutDurrëszhvilloitakimin e rradhëspërsaipërketPaketëssëSigurisënëShkollasipasporosisësëMinistrittëBrendshëm z. TaulantBalla. Ky takimvjennëkuadërtëzbatimittëplanittëmasavengainstitucionetnëfunksiontëdetyrimitligjor e institucionalpërnjëqasjetë re nëpunën e përbashkëtdhedetyrëspërkoordinimin, monitorimin e informiminditëpërditë e javë pas javebazuarnëPaketën e SigurisënëShkolla. PrefektiiQarkutDurrëssikryesuesiPaketëssëSigurisënëShkollavendositheksinpërmonitorimin e zbatimittëmasavelidhur me sigurinë e fëmijëvedhetërinjvebrendaperimetrittësigurisëshkollave. Nëkëtëkëndvështrimgjatëtakimit u kërkuanga ana e çdoinstitucioni, sipjesë e PaketëssëSigurisënëShkollazbatimiidetyravetëpërcaktuara, standartiligjorpërt’uzbatuar e respektuar me përpikmërinëfunksiontëparandalimitdhendalimittëtëgjithafenomenevesisfidë e shoqërisëtësëtashmespërsigurinë e nxënësvenëshkolla. Drejtuesit e institucionevetëkoordinojnëpunëndhebashkëpunojnëpërmonitorimindheinspektimin e shitësveushqimorë ambulant nga ana e AKU-s brendaperimetrittëpërcaktuar, monitorimin e kushtevetëhigjenës, cilësisësëujitnërrjetinhidrikbrendashkollave, shitjessëpijevealkoolikedheenergjike, duhanitpërnxënësitnënmoshën 18 vjeçnga ISHSH-ja, pajisjen

me mjetetëshuarjessëzjarritsi: rrjetihidrantdhebombolat me pudërnga MZSH-ja, vendosjen e sinjalistikësrrugorepranëobjektevearsimore, kontrolltërreptëpërlëvizjen e mjetevenëatë perimeter dhekryqëzimevepranëshkollavenga Policia Bashkiake, sidhenjërolthelbësornëmirëorganizimindhemirëkoordinimin e këtijprocesishumëtërëndësishëmkanëOficerët e Sigurisë, tëcilëtjanëtëparëtqëkonstatojnëçdofenomen, duke vënënëdijenisëparidrejtorinë e shkollës, ZVA-n përkatësdheinstancat e tjeraligjzbatuesepërparandalimin e kriminalitetit, përplasjevefizikemesnxënësve, përdorimin e lëndëvenarkotikedhefenomeneve me risk përsigurinëdhemirëqenien e nxënësvegjatëprocesitmësimor. Pjesë e kësajpaketesiguriepërfshihetedhekriminkibernetiknëdëmtëtëmiturve, duke adresuarnëkëtëmënyrëçdoshqetësim e çdoproblematikë. Nëpërfundimtëtakimit, u theksuarëndësia e bashkëpunimitsinjëekipndërinstitucionalpërpunën e përditshmenëmbarvajtjen e njëprocesisamëtërregullt e tësigurtpërgjatëgjithëvititshkollor 2023-2024.

**Mëdatë 19.01.2024**PrefektiiQarkutDurrës mori pjesënëvizitënzyrtaretëPresidentittëRepublikëssëShqipërisë Z. BajramBegajnëBashkinë e Shijakut. Vizita nisi nëbashkinëShijak, ku u biseduapërpunëtdheinvestimet e bëranëkëtëBashki, mbështetjenqëQeveriaShqiptarei ka dhënëShijakutnëproçesin e rindërtimitdheprioritetetpërtëardhmen. Më pas u vizituangjimnazi "16 Shtatori", shkollat 9-vjeçare "Lidhja e Prizrenit" dhe "PetritLlaftiu" tëgjithakëtoinstitucionearsimoretëndërtuaranga e para. VizitavazhdoinëdisabizneseqëoperojnënëkëtëBashki, kuPresidentitheksoirëndësinë e shtimittëinvestimeveseriozetëhuajasiedhetësipërmarrjevevendasepërzhvillimin e mëtejshëmtëzonës.
**Mëdatë 01.02.2024,**PrefektiiQarkutDurrësZ.Emiljan Jani, nëcilësinë e KryetarittëKomitetittëMenaxhimittëZonavetëMbrojturaMjedisore, zhvilloimbledhjen e këtijKomiteti. Nëkëtëtakimishintëpranishëmtëgjithëanëtarët e Komitetit, përfaqësuestë ADZM dhepërfaqësuestëinstitucioneveqëlidhen me menaxhimin e zonavetëmbrojturatëQarkutDurrës.
Nëkëtëmbledhje u prezantuadhe u diskutuaanaliza e punëssëAdministratëssëZonavetëMbrojturatëQarkutDurrëspërvitin 2023, ku u bënjëpanoramë e situatësaktuale, problematikavekryesoretëZonavetëMbrojturadheMonumentevetëNatyrëssidhe u parashtruanobjektivatpërvitin 2024.
Ndërtëtjera u diskutuagjendja e masavembrojtësedheparandaluesepërsituatat e zjarreve, gjendja e infrastrukturësrrugore, erozioni, aksionet e pastrimitsidherivitaliziminëZonat e MbrojturaMjedisore.
Nëpërfundim, Prefektikërkoiangazhimdhebashkëpunimmaksimaltëtëgjithastrukturavepërgjegjëse me qëllimmbrojtjendherritjen e vleravetëkëtyrezonavetëmbrojtura.
**Me datë07.02.2024** PrefektiiQarkutDurrës Z. Emiljan Jani zhvilloitakimin e parëtëKomitetitRajonaltëParandalimittëRadikalizmitnëluftënkundërEkstremizmittëDhunshëmnëQarkunDurrës, kjonëzbatimtëUrdhërittëKryeministrit. Nëtakimishintëpranishëm: Presidentja e organizatës “Linja e KëshillimitpërGradheVajza” znj. Iris Luarasi, Drejtuesja e QendrëssëKoordinimitKombëtarKundërEkstremizmittëDhunshëmznj. LejdiDervishi, sidhedrejtuestëinstitucioneveshtetërorenënivel vendor, aktorëkryesorënëluftënkundërfenomenittëradikalizmitdheekstremizmittëdhunshëm. Komiteti ka fokusparandalimin, identifikimindhereferimin e rastevenërrezikradikalizmi apo

tëradikalizuarqofshinindividë apo grupevulnerabëlnërrezik, sidhendjekjen e veprimevelidhur me proceset e rehabilitimit, ri-integrimitdherisocializimittëkëtyrëpersonavenënivelqarkusidhepranëKoordinatoritKombëtarpërParandalimindheKundërshtimin e EkstremizmittëDhunshëm. InstitucioniiPrefektittëQarkutDurrësofronmbështetjemaksimalepërkoordinimindhemirëmenaxhimin e çdo situate apo episodikonkretqëlidhetngushtësisht me radikalizmindheekstremizmin e dhunshëmnëterritorin e QarkutDurrës. Gjatëtakimit u miratuarregullorja e funksionimittëKomitetitRajonalnëtëcilënjanëtëpërcaktuararregullat e brendshmetëorganizimitdhefunksionimittëkëtijKomiteti.

**Me datë 15.02.2024**PrefektiiQarkutDurrës Z. Emiljan Jani zhvilloitakimin e parëtëKomitetitRajonaltëLuftëskundërTrafikimittëPersonavenëqarkunDurrëspërvitin 2024. Ky takimishtenëkuadërtëanalizëssëpunës 1-vjeçare tëveprimtarisëantitrafik, gjithashtudhesinjëaktivitetgjtihëpërfshirësicili ka siqëllimrritjen e ndërgjegjësimitdhebashkëveprimitndërinstitucionalnëmbrojtjetëviktimavetëkrimitnë “JavënKombëtareNdërgjegjësuesenëMbrojtjetëViktimavetëKrimit”.
Nëtakimishintëpranishëmanëtarët e KomitetitRajonalAntitrafik, Drejtues e përfaqësuestëorganeveligjzbatuese, Perfaqësuestë OJF-vesidhenjëgruptërinjshaktivëtëcilët u bashkuannjëzëri me institucionetnënsllogânin**#nëmbrojtjetëviktimavetëkrimit**.
PrefektiiQarkutnëfjalën e tijbërianalizën e punës 1-vjeçare tëkëtijKomitetipërvitin 2023, duke vlerësuarkontributin e përbashkëtdhebashkëpuniminshumëtëmirëqëekzistonnëkoordinimin e veprimevetëdrejtuesvetëinstitucionevepjesëmarrësenëuljen e fenomenitkrahasuar me një vit mëparë. Trafikimiipersonaveende sot konsiderohetnjëfenomenshqetësues, përposmekanizmaveligjorëdheinstitucionalëtëngriturpër ta luftuaratë. Pavarësishtnumravenëuljetërastevetëviktimave apo viktimavetëmundshmetëtrafikimitfenomenimbetetendekërcënimpotencialpërshoqërinë.
Nëtakimtërinjtëpjesëmarrëspasqyruanproblematikatedhesfidat me tëcilatatapërballennëmjediset e tyreshkollore. Sugjerimet e tyre u mirëpritënngatëpranishmittëcilëtdiskutuanmbimasatkonkreteqëjanëmarrëdhepritentëndërmerrennëgjetjen e zgjidhjevekonkretepërkëtoçështje. NëpërfundimPrefektivuritheksintekrëndësia e parandalimittëtrafikimiticilikërkonnjëbashkërendiminstitucionaltëvazhdueshëmdhepërfshirjeintegralet ëshoqërisë civile dheorganizatavetëndryshmepërmesfushatavesensibilizuese e informuesederitekrritja e kapacitetevetëpersonavepërgjegjëspërtunjohjur me proçeduratstandardetëveprimitnërastetëcaktuara. Sfida e tëgjithëve ne, ështëtëndërtojmenjëklimësolidaritetinëkomunitetettona, duke garantuar jo vetëmofrimin e shërbimevesamëcilësoretëdetyruarangainstitucionet, por edhe duke kontribuuaraktivishtnësigurimin e burimeve alternative qëofrojnëpërkrahjedhekujdestëvazhdueshëmpër ta, sishenjë e njëbashkëjetesekomunitareqënukpërjashtonaskëndngavëmendjadhekujdesi, duke filluarngafëmijëtdheçdokategoritjetërsocialenënevojë.

**Mëdatë 19.02.2024,**PrefektiiQarkutDurrësZ.Emiljan Jani dheSekretariiPërgjithshëmiPrefekturëssëQarkutDurrësZ.EdisonJonuzi, zhvilluannjëtakim me fokus: "Marrjen e masavepërpërmirësimin e punësnëdrejtimtëpastrimitdhembrojtjessëmjedisit".
Nëkëtëtakimishintëpranishëm: DrejtoriiNdërmarjessëShërbimeveKomunaleDurrës, DrejtoriNdërmarjessëShërbimeveKomunalePlazh, përfaqësuesngaNdërmarrjaRrugaUra, DrejtoriiPolicisëBashkiakeDurrës, përfaqësuesngaBashkiaKrujë, DrejtoriiAgjensisësëParqevedheKreacionitiBashkisëDurrësdhepërfaqësuestëAgjensisëRajonaletëMjedisit.
PrefektiiQarkuttheksoirëndësinë e sensibilizimitdhemobilizimittëpërbashkëtpërarritjetëmëtejshmenësektorin e menaxhimittëintegruartëmbetjevesinjëproçesmjaftirëndësishëmnëketëdrejtim.
Prefektikërkoingatëpranishmitvëmendjetështuarnëdrejtimtëmbrojtjessëmjedisitsidherealizimin e objektivavetëqarta duke u fokusuarnëhartimindhezbatimin e PlaneveVendoretëMenaxhimittëMbetjeve, identifikimin e hotspotevenëterritoret e bashkivepërrealiziminmë pas tëaksionevetëpastrimit, planifikimindheanagazhimin e burimevenjerëzore, mjetevepërpastrimin e tyredhetransportimin e këtyrembetjevenëpikat e përcaktuarasipasligjit.
Gjithashtu u diskutuanprioritetet e AgjensisësëParqevedheRekreacionitpranëBashkisëDurrës, nëdrejtimtëmenaxhimittëtyre, rivitalizimittëqytetitdhezonaveturistike, fondevedhe planet e tyretëveprimit. Njëtjetërçështjeqë u diskutuaishteangazhimiistrukturavepërgjegjësenëdrejtimtëndalimittëpërdorimittëqeseveplastikejashtë kritereveligjoredhemasat e marrangakëtostrukturanëkëtëdrejtim, kjoedhenëkuadërtëngritjesdhefunksionimittëTaskë-ForcësnëzbatimtëUrdhërittëKryeministrit.
**Me datë 28 .02. 2024**Prefekti i QarkutDurrës Z. Emiljan Jani zhvilloitakimin e Task-ForcësVendore Anti-Kanabis, nëkuadërtëintensifikimittëmasavedhezbatimittëdetyrimevetëpërcaktuaranëStrategjinëKundërKrimittë OrganizuardheKrimevetëRënda 2021-2025, Plan - Veprimit Vendor përparandalimindhegoditjen e veprimtarisëkriminaletëkultivimittëbimëvenarkotike.Takimi u drejtuangaPrefektiiQarkutDurrësZ.Emiljan Jani dhekishtesiqëllimintensifikimin e masave, bashkërendimin e veprimtarisësëInstitucioneveShtetëroreligjzbatuese, DegëveTerritorialedheNjësivetëvetqeverisjesvendorenëkuadërtëluftëskundërkultivimit e trafikimittëbimëveCanabis – Sativa. PrefektiiQarkutbërinjëpërshkrimtëpunësqëështëbërëderitaninëdrejtimtëparandalimit, ndërgjegjësimitdhekontrollitkundërKultivimitdheTrafikimittëKanabisit, ku u kërkoitëgjithëanëtarëvetë Task Forcësnjëritëmtëlartëpune, njëintensitettëlartëkontrolleshnëterren duke shfrytëzuartëgjithësistemet e informacionittëcilat do bëjnëtëmundurnjëkontrolltëplotë e njëmonitorimrigoroztëterritorit. NëpërfundimPrefektikërkoingatëgjithëinstitucionetpërmbushjen e detyrimitligjornëdrejtimtëshkëmbimittëinformacionevedhekontrollittëterritorit duke ushtruarkompetencatligjore, lëndoredheterritorialenëushtrimin e

detyravetëpërcaktuaramëlartdhesipasspecifikimevepërpërmbushjen me suksestëkëtijprioritetikombëtarkaqtërëndësishëm.

**Mëdatë 05.03.2024,**nëndrejtimin e PrefektittëQarkutDurrësZ.Emiljan Jani u zhvilluanjëtakimbazuarnëUrdhërin e Kryeministrit Nr.35, datë 19.02.2024 "Përpërbërjen, mënyrën e organizimitdhefunksionimintë Task – Forcëspërndalimin e përdorimit, hedhjesnëtreg, prodhimit, importimit apo futjesnëterritorin e RepublikësSëShqipërisëtëqeseveplastikembajtëse, sidheqeseveplastikembajtësetë oxo-degradueshmedhe oxo-biodegradueshme".

Gjatëtakimit, palëtdiskutuanmbirikoordinimin e punëssensibilizuesedhezbatimittëpërgjegjësivetësecilitinstitucion, përvijimin e kontrollevenëterrenpërndalimin e përdorimitdhetregtimittëqeseveplastikenjëpërdorimshmenën 70 mikron, sidhetëmarrjessëmasavetëparashikuaraligjorenërastetkurkonstatohetmoszbatimitiligjit.

PrefektinisurngaUrdhëriiKryeministriticiliparashikondisapërgjegjësidhedetyrimepërnjësëreinstitucionesh, siAgjenciaKombëtare e Mjedisit, InspektoriatiShtetëroriMbikqyrjessëTregut, apo edheNjësitë e VetëqeverisjesVendorepërmesPolicisëBashkiake, kërkoiangazhimmaksimalgjatëperiudhësnëvijimnëpërcaktimin e planevetëpunësdhekontrollevenëterren, nëmënyrëqëtëpërmbushindetyrimet e tyreligjorepërndalimin e përdorimit, tregtimitdhehyrjesnëvendintonëtëqeseveplastike.

**Me datë07.04. 2024**Prefekti i QarkutDurrës Z. Emiljan Jani ishteipranishëmnëceremoninë e rastitpranëbustittëMujoUlqinakutku u zhvilluanhomazhenëpërkujtimtë 85 vjetorittërezistencëssëdëshmorevendajpushtimitItalian.Tëpranishmitkryenhomazhenërespektdhemirën johjetëveprësheroiketëkëtyreheronjve, vendosënkurora me lule duke u përkulur me nderimpërparaaktitheroiktëatyrenjerëzveqësakrifikuangjithçkapërlirinëdhepavarësinëvendit.

**Mëdatë 08.04.2024**, PrefektiiQarkutDurrësZ.Emiljan Jani dheSekretariiPërgjithshëmiPrefekturëssëQarkutDurrësZ.EdisonJonuziorganizuannjëmbledhje me tëgjithëaktorëtpërgjegjëspërinfrastrukturënrrugorenëtërësi, sigurinë, mbirëmbajtjendhemenaxhimin e trafikutrrugornëQarkunDurrës. Kjombledhjeerdhiedhesinjënevojëpërtëanalizuarsituatën e përgjithshmëtërrugëve, problematikatdhenevojatpërbashkëpuniminndërinstitucional, por edhepërnjëmenaxhimgjithëvjetortërrugëvenëmënyrëoptimale.

Gjatëkësajmbledhje u diskutuanproblematikatkryesoretërrugëvetëqarkutDurrës, mirëmbajtjadhesigurianëaksetrrugore, hotspotet, përmirësimiisinjalistikësdhemasatqë do tëmerrennëvazhdimësinëkuadërtëparapregatitjespërsezoninveror 2024. Gjithashtu u diskutuaninvestimetdhendërhyrjet e ndryshmeqëjanëbërëgjatëkësajperiudhe apo qëparashikohentëbëhengjatëvitit 2024, nëpërmirësimin e situatëssërrugëvenacionaledheruralesidhe u parashtruandetyratpërtëardhmennëdrejtimtërritjessëefiktivitetitdhepërmirsimitparametravetësigurisë.

Nëfjalën e tijPrefektikërkoingatëpranishmitanalizimin e situatëssëpërgjithshmetërrugëvenëkuadërtëparapërgatitjespërsezonin e rituristik 2024, cilipadyshimqëgjatëkëtijviti do tëjetëmjaftintensiv, nëkëtëkëndvështrimduhetqëedhesiguriarrugoretëjetënëkushtesamëtëmiranëçdodrejtim. Po kështungatëpranishmit u prezantuasituataaktuale e rrugëve, dhe u

adresuanproblematikatpërkatësepërtëcilat u kërkuaangazhimmaksimaldhekoordinimndërmjetstrukturave, nëveçanti me strukturat e PolicisësëQarkullimitRrugor.
NëpërfundimPrefektikërkoiangazhimindhekoordinimin e punës me qëllimpërmirësimindhezgjidhjen e problematikavenëkohë, nëdrejtimtëkrijimittëgjithëinfrastrukturës apo shërbimevetënevojshmepërsezoninturistik 2024.

**Mëdatë 13.05.2024**, PrefektiiQarkutDurrësZ.Emiljan Jani nëcilësinë e KryetarittëKomitetittëMenaxhimittëZonavetëMbrojturaMjedisore, zhvilloimbledhjen e dytëpërkëtë vit tëkëtijKomiteti. Nëkëtëtakimishte e pranishmeDrejtoresha e Përgjithshme e AgjencisëKombëtaretëZonavetëMbrojtura, Znj. Daniel Pirushi, anëtarët e Komitetit, përfaqësuestë ADZM, sidhepërfaqësuestëinstitucioneveqëlidhen me menaxhimin e zonavetëmbrojturatëQarkutDurrës.
Fokusikryesornëkëtëtakimishteprezantimi me risitë e rejaqësjellligji "PërZonat e Mbrojtura", iamenduarnëfillimtëkëtijviti, me syniminpërtëvendosurnjëekuilibër midis zonavetëmbrojturadhenevojësqëkanëkomunitetetdhepushteti vendor përzhvilliminekonomiktëterritorevetëtyre, sidhepërnjëriformulim e qartësimtëaktivitetevetëlejuaranëkëto zona.
Synimiihartimittëinstrumentavetëtillë, ështënxitja e zbatimittëmodelevetëqëndrueshmetëzhvillimitekologjikdheekonomiknëzonat e mbrojtura apo parqetkombëtare, ruajtja e ekosistemitdhediversitetitbiologjik, sidhereduktimiipresionit jo tëqëndrueshëm apo abuzivmbiburimetnatyrore.
Ndërtëtjera u bënjëpanoramë e situatësaktuale, puna e bërëgjatë 4- mujorittëparëtëvitit, u diskutuambigjendjen e masavembrojtësedheparandaluese, përsituatat e zjarreve, gjendja e infrastrukturësrrugore, erozioni, aksionet e pastrimitsidherivitalizimiimonumentevetëtrashëgimisëkulturoresiaseteqërrisinatraksionetturistiketëqa rkut.
Tëpranishmitadresuandisangaproblematikat e konstatuaragjatëpunëssëtyre, përtëcilatPrefektikërkoiangazhimdhebashkëpunimmaksimaltëtëgjithastrukturavedheinstitucionevepër gjegjëse.
U caktuandetyratpërkatësepërçdostrukturembimarrjen e masavetënevojshmenëkëtëpragfillimitësezonitveror, me qëllimmbrojtjendherritjen e vleravetëkëtyrezonavetëmbrojtura.

**Me datë 15 .05.2024**PrefektiiQarkutDurrës Z. Emiljan Jani zhvilloitakimin e KomitetitRajonaltëZhvillimittëTurizmit.Qëllimiikëtijtakimiishtebashkërendimi e veprimtarisësëInstitucioneveShtetëroreligjzbatuese, DegëveTerritorialedheNjësivetëvetqeverisjesvendorenëmënyrëqësezonituristikveror 2024 tëfunksionojënëkushtesamëtëmira. Gjatëtakimittëpranishmitprezantuan planet e veprimittëhartuaranga ana e tyrepërmenaxhimin e sezonitturistikveror 2024,

analizuanmasatqëjanëmarrëderimëtani, shërbimet e kryera apo që do tëkryennëvazhdimësi, sidheproblematikat e konsatuarangasezoniikaluar. Prefektinëfjalën e tijnënvizojrëndësinë e marrjessëtëgjithamasavenëdrejtimtëkrijimittëtëgjithakushteve, shërbimevedheinfrastrukturëssënevojshmekryesishtnëzonatturistikenëdrejtimtëpastërtisë, procesittëhartëzimittëzonaveturistike, përcaktimittëstacionevetëplazhitpublikdheprivatsipastëgjithakriterevetëpërcaktuaranë VKM-së 171 datë 27.03.2019 përmiratimin e rregullores "Përkushtetdhekriteret e ushtrimittëveprimtarisësëstacionittëplazhit", proceduravetëaplikimitnë e-albaniatësubjektevetëndryshmedheproceduravetëaplikimitnë e-albaniapërobjetet me strukturëtëçmontueshme. Nëpërfundimpalëtshprehënangazhimin e tyretëplotëpërtëvijuarmëtejbashkëpuniminndërmjetinstitucioneve, me qëllimngritjen e kapacitetevenëofrimin e kushtevetësigurisë, qetësisëdhestandardevetëlartapërçdovizitordheturist!

**Me datë 15 .05.2024**PrefektiiQarkutDurrës Z. Emiljan Jani ishteipranishëmnëPanairin e Punës&Karrieres, në "UniversitetinAleksandërMoisiuDurrës". Ky panairështëvendikukompanidheinstitucionetëndryshmetakohen me studentedhe alumni përtëofruarpozicionevakantetëpunës, trajnime, praktikastudentoredheintershipe me qëllimforcimin e uravetëbashkëpunimit, nëkëtëmënyrëshumëtërinj e tëreja do tëkenëmundësifalëprofesionalizmitdhepunëssëtyretëndërtojnëtëardhmennëqytetintonë.

**Me datë 30.05.2024** Prefekti i Qarkut Durrës Z. Emiljan Jani në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit Nr 69, datë 30.04.2024 për ngritjen e Task-Forcës Ndërinstitucionale për Sezonin Turistik Veror 2024, organizoi sot mbledhjen e parë të Task-Forcës për Sezonin Turistik Veror 2024. Në fokus të këtij takimi ishte njohja me situatën aktuale, masat e marra deri më tani në drejtim të sezonit të turistik, shërbimet e kryera, apo që do të kryhen në vazhdimësi, problematikat e hasura, si dhe planet konkrete të veprimit të hartuara nga të gjithë institucionet për menaxhimin e sezonit turistik veror 2024. Duke marrë shkas nga problematikat e dala gjatë sezonit veror të kaluar, nga Prefekti i Qarkut u kërkua koordinim ndërinstitucional i punës në lidhje me plotësimin e detyrimeve të parashikuara në ligj mbi masat paraprake që duhet të merren nga Bashkitë dhe Degët Tërritoriale, për të patur një sezon turistik të mirë organizuar. Këto masa duhet të jenë sa më rigoroze dhe të marra në kohë me qëllim që fillimi i sezonit turistik 2024 të na gjej pa problematika në këtë drejtim. Prefekti nënvizoj dhe një herë detyrimet ligjore që kanë të gjithë aktorët për zbatimin e akteve ligjore në fuqi, detyrat dhe kompetencat që ka secili sektor për të monitoruar, kontrolluar dhe vënien përpara përgjegjesise ligjore të gjitha subjektet që proçedojnë në informalitet dhe në kundershtim me ligjin. Nga diskutimet e të pranishmëve në këtë takim u ngritën problematika të ndryshme në drejtim të aspektit teknik të punës për të cilat do të punohet për ti dhënë zgjidhje në kohë për të bërë të mundur krijimin e të gjithë infrastrukturës apo shërbimeve të nevojshme për sezonin turistik veror 2024. Në përfundim të takimit Prefekti u la detyrë të pranishmëve, përcaktimin e qartë të objektivave të punës, në mënyrë që të krijojmë jo vetëm klimën e duhur për një turizëm bashkëkohor dhe të standartizuar, por në të njëtën kohë të krijojmë mundësinë që sektori i turizmit të shërbejë si një nxitës i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik për qarkun tonë dhe më gjerë.

**Me datë 05.06.2024** Në zbatim të detyrimeve ligjore që lindin në drejtim të sigurisë në zonat bregdetare gjatë sezonit turistik, Task-Forca Ndërinstitucionale për Sezonin Turistik Veror 2024, me urdhër të Prefektit të Qarkut Durrës Nr.33, datë 27.05.2024, ka vijuar kontrollin në terren për verifikimin e VENDBAZIMEVE të ngritura sipas kritereve të përshkruara në VKM-t përkatëse. Kontrolli ka vijuar në të gjitha vendbazimet që gjenden në vijën bregdetare nga Ura e Dajlanit deri tek Përroi i Agait. Kontrolli është kryer nga grupi i Task-Forcës i përbërë nga: Institucioni i Prefektit, Policia Vendore e Qarkut Durrës, Policia Vendore e Kufirit dhe Migracionit, Drejtoria e Përgjithshme Detare, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, Policia Bashkiake Durrës. Ky inspektim ka si qëllim garantimin e një sezoni turistik të përshtatshem dhe sigurtë për të gjithë pushuesit, duke kërkuar në mënyrë të veçantë vëmëndje të shtuar në garantimin e sigurisë së jetës. Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës përmes mekanizmit Task-Forcë të ngritur për këtë qëllim do të vazhdojë kontrollin dhe monitorimin gjatë gjithë sezonit jo vetëm në zonën e plazhit të Durrësit, por edhe në të gjitha destinacionet e tjera turistike në të gjithë territorin e qarkut.

**Me datë 10.06.2024**Nëzbatimtëdetyrimeveligjore, Task-ForcaNdërinstitucionalepërSezoninTuristikVeror 2024, me UrdhërtëPrefektittëQarkutDurrës, djemëdatë 10 qershor 2024 ushtroikontrollnëgjirin e DurrësitngaUra e DajlanitderitekPërroiiAgait. Ky kontrollkishtesiqëllimzbrazjendhelirimin e plazhevepubliketëzaptuaranëmënyrëabuzivengasipërmarrjet private dheqytetarëtëndryshëmsidheverifikimin e masavetësigurisëdheelementëtëtjerëtërëndësishëmpërnjësezontëmbarëdhetësigurtë, duke bërëtëmundurrespektimin e tëgjithëstandartevedherregullavetëpërcaktuaranëligj. Pjesë e grupittë Task-Forcësishin: AgjenciaKombëtare e Bregdetit, Policia Bashkiakedhe Policia e Rendittëcilëtliruantëgjithahapësirat e zënatëplazhevepublikesingasipërmarrjet private, ashtuedhengaqytetarëttëcilët me vendosjen e çadravedhekyçjen e tyrenëkëtohapësiraqëipërkasintëgjithëve, shndërtohennënjë problem madhorpërtëtjerëqytetartëcilëtkërkojnëtëpushojnënëplazhetpublike. Nëpërfundimtëaksionitiu la detyrësubjektevedheqytetarëveabuzuestëmosicënojnëmëhapsiratpublike, pasinëtëkundërt do tëpërballen me tëgjithëfuqinë e ligjit. Zbatimiimasavetësigurisëdherespektimiihapësiravepërplazhepublikesiguronqëturistëtëhuajdhevendast ëshijojnëqetësishtditët e tyretëpushimitnëbregdetintonë.

**Me datë 11.06. 2024**NëzbatimtëporosisësëMinistrittëBrendshëmZ.TaulantBalla, PrefektiiQarkutDurrësZ.Emiljan Jani, organizoj sot njëtakimkonsultativ me Shefat e SektorëvetëInstitucionittëPrefektit me praninë e Z.FlamurMamajKëshilltariMinistrittëBrendshëmdhe Z. ArbenXhaferiDrejtoriPolitikavetëÇështjeveVendorenëMinistrinë e Brendshme. Nëkëtëtakimtëpranishmitdiskutuandhendanë argumenta nëdrejtimtëpërmirësimittëperformancësdherritjessëefiçensëssëLigjit nr. 36/2024 “Përdisashtesadhendryshimenëligjin nr. 107/2016 “PërPrefektin e Qarkut”, ProjektvendimitpërKëshillatVendorëtëSigurisëPublikedheKëshillitKombëtartëSigurisënëKomunitet, sidhembimasat e marrasipas Planit tëVeprimitpërsezoninturistikveror 2024.

Objektitryezëssësotmeishtemarrja e mendimevedherekomandimevekonkretenëfunksiontënjë administrate efikase, transparentetëorientuardrejtqytetarëve, tëcilat do tëpërfshihennëdraftin final qëMinistria e Brendshme do t'iparaqesëKëshillittëMinistravepërmiratim.

**Me date 25 qershor 2024** Task ForcaNdërinstitucionalepërSezoninTuristikVerorushtroikontrollnëterrenpërvendbazimetdhelirimin e plazhevepublike. Pjesë e grupittëpunësishin: PrefekturaDurrës, Policia Vendore e Qarkut, Policia BashkiakeDurrës, Kapiteneria, BashkiaDurrës, Policia Vendore e KufiritdheMigracionitdheAgjenciaKombëtare e Bregdetit. Kontrolli u shtrinëvijënbregdetarengaUra e DajlanitderitepërroiiAgait, ku u liruanplazhetpubliketëzaptuarangavetëqytetarëtqënukiheqinçadratdheshezglongët pas largimitngaplazhidhepërmëtepër u kontrolluan me përpikmëritëgjithakriteretpërushtrimin e veprimtarisënga ana e operatorëveturistikpërzbatimin e largësisëdhegjatësisësëkorridorevetëvendbazimeve, vendosja e flamujveorientues, tabelat me tëgjithatëdhënat e nevojshmepërqytetarëtdhegjithëkatjetërnëshërbimtënjëshërbimicilësorpërsigurine e pushuesve.

**Mëdatë 28.06.2024,** u mor pjesënëkonferencën e organizuarngaInstitutiiStatistikavepërpublikimin e rezultatevekryesoretëCensittëPopullsisëdheBanesave 2023, tekTeatrii Operas dheBaletitnëqytetin e Tiranës .Ky cens, vlerësoinëterritorinshqiptarnëdatë 18 shtator 2023, 2 412 113 banorë, tëcilëtpërbëjnë 755 950 familje, me madhësimesatare 3.2 anëtarëpërfamilje, tëcilëtjetojnënë 1 082 529 banesatëzakonshme. CensiiPopullsisëdheBanesave do tëofrojëtëdhënatëvlefshmepërtëhartuarpolitikamëtëmiranëtëgjithafushat, arsim, shëndetësi, ekonomidhezhvillimtëqëndrueshëm.

**Mëdatë 11.09.2024**, u mor pjesënëtakimin e rradhëssë Task-Forcëspër ndalimin e përdorimit, hedhjes në treg, prodhimit, importimit apo futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të qeseve plastike mbajtëse, si dhe të qeseve plastike mbajtëse të oxo-degradueshme dhe oxo-biodegradueshme, nëambientet e MinistrisësëTurizmitdheMjedisitnënkryesimin e ZëvendësministressëTurizmitdheMjedisitznj. Almira Xhembulla. Nëkëtëtakim u diskutuapërmbarëvajtjen e punëstëkësaj Task-Force, reagiminpozitivqëkanëpasurtregjetnëpërdorimin e qeseveplastikekonformligjit, sidhevazhdimin e bashkëpunimitndërmjetinstitucionevepërtëvijuar me inspektimetsipaskalendarittepunes. Gjithashtunjëndihmesëtërëndësishme do tëjapiedheprojektligji "Përmenaxhimin e integruartëmbetjeve", icili ka dalëpërkonsultim.

**Me datë 11 .09. 2024**Nëdrejtimin e PrefektittëQarkutDurrës Z. Emiljan Jani, u mbajtmbledhja e rradhëssë Task ForcësNdërinstitucionlepërSezoninTuristikVeror 2024, me fokusmbarëvajtjen e sezonitturistik. Nëtakim u shtruanpërdiskutimnjë mori çështjeshpërsaipërketproblematikavetëhasurasi:
Subjekte private tëcilatushtrojnëaktivitetin e tyre nëkundërshtim me ligjindherregullatpërstacionet e plazhit;

Plazhetpublikedhezaptimii tyre ngavetëqytetarëttëcilët me mosheqjen e çadravetë tyre shndërrohennëpengesëpërqytetarëtëtjerëtëcilëtkërkojnëtëpushojnëtënesërmennëhapësirat e pëazhevepublike;
Subjekte private tëcilatnukjanëpajisur me asnjëdokument, apo lishencëpërkatësepërushtrimin e aktivitetittë tyre nëterren.
Ndërtëtjera u evidentuanedhearritjenëfillimtësezonitturistiksi:
Largimiishitësveambulantënëvijënbregdetare;
Largimiilypsavengazonat me ndjeshmëritëlartëturistike;
Marrja e masavepërlirimin e hapësiravetëplazhevepublikenga Kepi iRodonitderinëplazhin e PërroittëAgait;
Bllokimidhevendosja e masave administrative kundrejtatyresubjektevenëkonflikt me ligjinpërturizmin;
Mirërregullimiiqarkullimitnëakset me instensitettëlartëtrafikupranëzonaveturistike.
Nëpërfundimtëmbledhjes u radakordpërvijueshmërinë e monitorimeve, kontrollevedhemarrjen e masave administrative përcilindoqëabuzon me hapësiratpublikenëzonatturistike.
**Me date 11 .09. 2024** Nëndrejtimin e PrefektittëQarkutDurrës Z. Emiljan Jani u mbajtmbledhjapërfillimin e vititërishkollor 2024-2025. Mbledhja u përqendruanëfillimin e vitittërishkollor, duke paturnjëvëmendjetështuarrrethdisaelementevedyçpërnjëmbarvajtjetësuksesshmesi:

1. Dezinfektimi dhe dezinsektimi i mjediseve të institucioneve të arsimit parauniversitar;
2. Lyerjedhemeremetimetëmjediseve të institucioneve të arsimit parauniversitar;
3. Procesiishpërndarjessëlibravenëtërësidheveçanarishtpërklasën e parë;
4. Plotësimi i vendevevakante me personelpedagogjiktëkualifikuarnëpërmjetportalitqeveritar “MësuespërShqipërinë”;
5. Mirëorganizimi për frekuentimin e institucioneve të arsimit parauniversitar nga komuniteti rom dhe egjyptian;
6. Rritje e sigurisë ndaj shumë fenomeneve dhe mbrojtja nga Oficeri i Sigurisë.

Në përfundim të mbledhjes Prefekti i Qarkut Durrës la disa detyra të qarta për mirëorganizimin dhe përputhshmërinë ligjore për një mësimnxënie sa më cilësore, ku theks të veçantë i vendosi raportimeve nga ana e ZVAP-ve kundrejt Institucionit të Prefektit të Qarkut Durrës të cilat do të duhet të jenë në kohë reale, pa vonesa dhe sipas asaj që parashikon ligji.

**Me datë 18.09.2024** Nën drejtimin e Prefektit të Qarkut Durrës Z. Emiljan Jani u realizua mbledhja në kuadër të nalizimit të punës dhe veprimtarisë mbi zbatimin e detyrimeve ligjore të Task-Forcës Ndërinstitucionale për Sezonin Turistik Veror 2024. Në këtë takim u zhvillua analiza e punës së kësaj Task-Force, u paraqitën rezultate konkrete mbi detyrat dhe funksionet e kryera gjatë sezonit turistik veror 2024, u analizuan arritjet dhe problematikat e evidentuara në terren nga të gjithë institucionet që ofrojnë shërbime në drejtim të turizmit si dhe u diskutua mbi mundësinë e zgjidhjes së tyre përmes

qasjeve të reja, mbështetur në kompetencat që ofron ligji, për ti paraprirë sezonit të ardhshëm turistik 2025. Prefekti në fjalën e tij theksoi se ky viti ishte një përvojë e suksesshme e bashkëpunimit mes strukturave, të vetëqeverisjes vendore, degëve territoriale, institucioneve të administratës shetërore, falë të cilëve u sigurua një sezon turistik i suksesshëm me tregues të kënaqshëm. Në mënyrë të veçantë Prefekti në fjalën e tij, nënvizoj marrjen e masave nga Bashkia Durrës, për sa i përket krijimit të kushteve të favorshme për t'i paraprirë implementimit të Ligjit të ri që pritet të dalë së shpejti për menaxhimin e plazheve, për të cilin Kryeministri Z. Edi Rama ka një qasje tëresisht të re.

**Mëdatë 15.10.2024,** PrefektiiQarkutDurrësZ.Emiljan Jani dheKoordinatoriiPërgjithshëmiPrefekturëssëQarkutDurrësZ.EdisonJonuziorganizuannjëmbledhje me tëgjithëaktorëtpërgjegjëspërinfrastrukturënrrugore, sigurinë, mirëmbajtjendhemenaxhimin e trafikutrrugornëQarkunDurrës. Gjatëkësajmbledhje u diskutuanproblematikatkryesoretërrugëvetëqarkutDurrës, mirëmbajtjadhesigurianëaksetrrugore, përmirësimiisinjalistikësdhemasatqë do tëmerrennëvazhdimësinëkuadërtëparapregatitjespërsezonindimëror. Gjithashtu u diskutuaninvestimetdhendërhyrjet e ndryshmeqëjanëbërëgjatëkësajperiudhe apo qëparashikohentëbëhennëvijim, nëpërmirësimin e situatëssërrugëvenacionaledheruralesidhe u parashtruandetyratpërtëardhmennëdrejtimtërritjessëefiktivitetitdhepërmirësimitparametravetësigurisë. NëpërfundimtëmbledhjesPrefektikërkoiangazhimindhekoordinimin e punës me qëllimpërmirësimindhezgjidhjen e problematikavenëkohë, nëdrejtimtëkrijimittëgjithëinfrastrukturës apo shërbimevetënevojshme.

**Me datë 27 .11.2024** Prefekti i Qarkut Durrës Z. Emiljan Jani në cilësinë e Kryetarit të Task Forcës Rajonale për Sigurinë në Shkolla, nisur nga ngjarja e rëndë tronditëse e ndodhur shkollën “Fan Noli” në Tiranë, nga e cila humbi jetën nxënësi Martin Cani, zhvilloj një takim mbi sigurinë në shkolla. Në këtë kontekst mbledhja përfshiu Drejtues të Institucioneve që përbëjnë këtë Task-Forcë Rajonale. Prefekti si kryesues i Paketës së Sigurisë në Shkolla, kërkoi nga të pranishmit një analizë te detajuar të situatës reale të sigurisë në shkolla, identifikimin e masave plotësuese të menjëhershme në drejtim të sigurisë, rritjen e ndërgjegjësimit për edukimin qytetar për të garantuar që çdo shkollë të jetë një vend, ku të mbizotërojë jo vetëm arsimi cilësor, por edhe siguria e të gjithë komunitetit shkollor. Në këtë këndvështrim gjatë takimit u kërkua që kjo ngjarje të shërbejë si një kambanë e fortë për të gjithë strukturat për marrjen e masave urgjente për fuqizimin e mekanizmave të parandalimit të dhunës, rishikimin e protokolleve të ndërhyrjes së shpejtë të oficerëve të sigurisë, punonjësve social dhe psikologëve në shkolla, zgjerimin e platformave të sinjalizimit të hershëm, të çdo forme të dhunës, si dhe forcimin e shërbimeve sociale në strukturat arsimore dhe komunitet. Nga diskutimet u theksua rëndësia e Oficerëve të Sigurisë si një hallkë e pazëvendësueshme dhe vlerë e shtuar në sigurinë e nxënësve. Mbetet gjithmonë thelbësor roli sa më aktiv i të gjitha palëve, prindër, mësues, punonjës të policisë së shtetit, institucione arsimore por edhe komuniteti, për të bërë të mundur parandalimin e ngjarjeve të tilla në të ardhmen. Siguria e fëmijëve është prioritet absolut dhe fuqizimi i mekanizmave të parandalimit ndaj çdo forme dhune brenda apo jashtë shkolle, mbetet angazhimi i përbashkët.

**Mëdatat 03.12.2024** dhe **04.12.2024,** u mor pjesenëtrajnimin e organizuarngaAgjenciaKombëtare e Mbrojtjes Civile me qëllimforcimin e kapacitetevetëmbrojtjes civile nënivelqarkudhebashkienëfushën e menaxhimittëriskuttëfatkeqësive. Ky trajnim u kryengaekipi i ekspertëvetë "SEA Consulting", nënmonitorimindhekoordinimin e AKMC, icilisynonteforcimin e kapacitetevenjerëzoretëpushtetit vendor përvlerësimin e rreziqevetematike - sizmike, përmbytjet, zjarret në pyje, rrëshqitjet e tokës, riskunteknologjikdhebiologjik, dheishërbenfuqizimittëParimittëSubsidiaritetitnë 12 qarqedhe 61 bashki.
**Me datë 10 dhjetor 2024**Prefekti i QarkutDurrës Z. Emiljan Jani organizoitakimin me pjesëmarrjen e Z. ArbenXhaferri, DrejtoriPolitikavetëÇështjeveVendorenëMinistrinë e Brendshme, përfaqësuesessëPrezencëssë OSCE–sënëShqipëriZnj. EldisaLloshi, Zv/ KryetarevetëNjësiveVendoresidhepërfaqësuesvetëinstitucionevekryesorepërsaipërketsigurisëpublike. Nëkëtëtakim u prezantuan me detajeelementët e VKM -së nr. 678, datë 30.10.2024, "Përpërbërjen, rregullat e hollësishmetëorganizimit, funksionimittëKëshillave Vendor tëSigurisëPublike (KVSP) dheKëshillitKombëtartëSigurisënëKomunitet (KKSK)". U diskutuambiafatetkohore, pjesëmarrësitdherolin e gjithsecilitnëkëtëproçes. Ky vendimpërfaqësonnjë hap tërëndësishëmdrejtforcimittëmekanizmavetësigurisëpublikedhebashkëpunimitndërinstitucionalpërmirëqenien e komunitetit, ndërkohëtëpranishmitshprehenangizhimtëplotëpërrealiziminefektivtëkëtijmisionitëpërbashkët.

**Mëdatë 11.12.2024,** u mor pjesënëseminarin e organizuarngaMinistria e TurizmitdheMjedisitnëambjentet e saj, me temë "Reduktimiindikimittëprodukteveplastikenëmjedis", organizuarsipjesë e programit "RezistencadheZhvillimiiGjelbër" zbatuarngaAgjenciaFranceze e Zhvillimit (AFD) dheEkspertiza Franca, nëkuadërtë Task Forcëspërqesetplastike.
**Me datë 13 dhjetor 2024**Prefekti i QarkutDurrës Z. Emiljan Jani mori pjesënëtakimin me Ministrin e Brendshëm Z. Ervin Hoxha dhePrefektët e Qarqevetëvendit, nëqytetin e Korçës. Nëtakim u diskutuambizbatimin e paketëssësigurisënëshkolladhesimundtëintegrohetprojekti "Smart City" përruajtjen e perimetrittësigurisënëinstitucionetarsimore. RoliiPolicisësëShtetitdheistafitpedagogjikpërtëpasurnjë ambient mëtësigurtështëshumëirëndësishëm. Modeliqëndjekinnxënësitështëgjithashtushumëirëndësishëm. U diskutuagjithashtuedhepërçështjetëemergjencave civile dhemirëmenaxhimin e situatësspërgjatëstinëssëdimrit.

**Mëdatë 17.12.2024**, u mor pjesënëmbledhjen e KomitetittëMenaxhimittëZonavetëMbrojturaTiranë, mbajturnëPrefekturën e QarkuttëTiranës. Nëkëtëtakim u analizuapuna e bërëngaAdministrataRajonale e ZonavetëMbrojturapërvitin 2024, u bëprezantimiiprojektit UNDP në PK Mali iDajtit, prezantimii BE UE4 Nature dheasistencapërmenaxhimin e PK Mali iDajtit. Gjithashtu u diskutuanproblematikatqëkanë Nj. Administrative nëkëto zona, siguria e vizitorëve, çertifikimiishtigjevetëreja, sidhebashkëpunimii ARZM me bashkinëpërguidatturistike.

**Me datë 20 dhjetor 2024**Prefekti i QarkutDurrës Z. Emiljan Jani organizoinjëtakim, kuishintëpranishëmpërfaqësuestëinstitucionevetëadministratësshtetëroreqëndroredhevendoreqëofrojn ëshërbimendajkomunitetitnëlidhje me masat e marrasidhe planet e veprimittëhartuaranga ana e tyrembimbarvajtjen e festavetëfundvititdhefillimittëVitittë Ri 2025. Nëkëtëtakimishintëpranishëm: DrejtoriiSpitalitRajonalDurrës z. Ani Dyrmishi, DrejtoriPolicisëBashkiakeDurrës z. VasipÇopa, ShefiiKomisariatitPolicisëDurrës z. Gerald Agalliu, ShefiiKomisariatitPolicisëShijak z. Ilia Muça, Krye\InspektoriPolicisëBashkiakeShijak z. NezirKeçi, përfaqësuesngaInspektoriatiShtetërorShëndetësor z. KlejdiNdonisidhepërfaqësuesenga AKU. Nëfjalën e tijPrefektitheksojfaktin se ndodhemipërparafestavetëfundvitit, çdoinstitucionduhettëhartoj planet e masavesipasfushavetëtyretëpërgjegjësisëkutëjenëpërcaktuarqartëobjektivatdhedetyrimetnëpërmjettëci lavetësynohetrritja e renditdhesigurisëpublikedheofrimiishërbimevesamëtëplotandajkomunitetit. Nisuredhengapervoja e vitevetëkaluara, apo e ngjarjevetëndodhura, Prefektivleresojtëdomosdoshmemarrjen e disamasaveshtese, sidhekalimin e tëgjithestrukturavetëPolicisësëShtetit, PoliciveBashkiake, PolicisëKufitaredheMigracionit, AKU-s dhe ISHSH-s nëgatishmëridheshërbimitëpërforcuar. Nëmënyrëtëveçantë, u kërkuagatishmëri e plotë me qëllimsigurimin e renditdheqetësisëdheparandalimin e vepravekriminale, gjithashtu u kërkuavëmendjedhemonitorimnëakseverrugorepërnjëqarkullimsamë normal tëautomjeteve, krijimiilehtesiraveligjore ne pikat e kalimittëkontrollitkufitarsidhekontrollidhembikqyrja e tëgithamallravetëkonsumit. Bashkëpunimimesinstitucionevetëpranishme e veçanarisht midis PolicisësëShtetitdhePoliciveBashkiakeështëthelbësorpërpërmbajtjen ne kontrolltësituatëssësigurisë, me qëllimbashkërendimindhekoordinimin e masavepërparandalimin e hedhjesnëtregtëlëndëvepiroteknikedhefishekzjarrëvedhepërdorimin civil, qërrezikojnësigurinëpublike, jetëndheshëndetin e qytetareve. InstitucioniiPrefektittëQarkutDurrësnëpërmjetkëtyremasavesynon, që Festa e Krishtlindjesdhe e Vitittë Ri tëkalojnënëmënyrësamë festive dhetëmosvenitennga episode tëmundshmepaligjshmërie.

**II. Drejtimi i TaskForcaveVendore, krijimi i organizmavetëpërkohshëm, tëkomitetevetëgrupevetëpunësdhetëkomisionevepërçeshtjetëcaktuara:**

**Task Forca Vendore Antikanabis**

Gjatë periudhës Janar –Dhjetor 2024, në territorin e Qarkut Durrës dinamika e kriminalitetit me tendencë kultivimin e bimëve narkotike paraqitet si më poshtë :

Dhunanëfamilje

Evidentuar 291 raste, zbuluar 291 ose 100%, autorë 313, arrestuar 112, ndaluar 14, nëgjëndjetëlirë 172, nëkërkim 15.

Evidentuar 141 raste, zbuluar 140 ose 99.29%, autorë 164, arrestuar 9, ndaluar 7, nëgjëndjetëlirë 138, nëkërkim 10.

Vrasje

Evidentuar 6 raste, zbuluar 6 ose 100%, autorë 9, arrestuar 5, ndaluar 3, nëgjëndjetëlirë 1, nëkërkim 0.

## KOMITETI I MENAXHIMIT TË ZONAVE TË MBROJTURA MJEDISORE

Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura, Durrës ka në administrim dhe menaxhim këto zona të mbrojtura:Parku Natyror "Qafështamë", Kategoria IV, me sipërfaqe 6864.36 ha, shpallur me VKM-në Nr. 60, datë 26.01.2022

1. Peizazh i Mbrojtur "Krastë-Verjon" me sipërfaqe 1470.1 ha, shpallur me VKM nr. 595, datë 25.09.2024
2. Peizazhi i Mbrojtur Ujor/Tokësor "Rrushkull" me sipërfaqe 579.5 ha, shpallur me VKM nr. 589, datë 25.09.2024
3. Peizazhi i Mbrojtur Ujor/Tokësor "Bisht – Kamzë" me sipërfaqe 491.5 ha, shpallur me VKM nr. 592, datë 25.09.2024
4. Parku Kombëtar "Mali i Dajtit", nga të cilat 2444 ha në administrim të AdZM Durrës, shpallur me VKM-në Nr. 59, datë 26.01.2022
5. AdZM Durrës ka në administrim dhe 18 Monumente Natyre, të shpallura me VKM nr. 187, datë 25.03.2021 "*Për disa ndryshime dhe shtesa", të VKM nr. 303, datë 10.05.2019 "Për miratimin e listës së rishikuar të përditësuar, të monumenteve të natyrës shqiptare*".

**Takimet kryesore të zhvilluara gjatë vitit 2024 janë:**

**Mëdatë 01.02.2024,**PrefektiiQarkutDurrësZ.Emiljan Jani, nëcilësinë e KryetarittëKomitetittëMenaxhimittëZonavetëMbrojturaMjedisore, zhvilloimbledhjen e këtijKomiteti. Nëkëtëtakimishintëpranishëmtëgjithëanëtarët e Komitetit, përfaqësuestë ADZM dhepërfaqësuestëinstitucioneveqëlidhen me menaxhimin e zonavetëmbrojturatëQarkutDurrës. Nëkëtëmbledhje u prezantuadhe u diskutuaanaliza e punëssëAdministratëssëZonavetëMbrojturatëQarkutDurrëspërvitin 2023, ku u bënjëpanoramë e situatësaktuale, problematikavekryesoretëZonavetëMbrojturadheMonumentevetëNatyrëssidhe u parashtruanobjektivatpërvitin 2024. Ndërtëtjera u diskutuagjendja e masavembrojtësedheparandaluesepërsituatat e zjarreve, gjendja e infrastrukturësrrugore, erozioni, aksionet e pastrimitsidherivitaliziminëZonat e MbrojturaMjedisore. Nëpërfundim, Prefektikërkoiangazhimdhebashkëpunimmaksimaltëtëgjithastrukturavepërgjegjëse me qëllimmbrojtjendherritjen e vleravetëkëtyrezonavetëmbrojtura.

**Mëdatë 13.05.2024**, PrefektiiQarkutDurrësZ.Emiljan Jani nëcilësinë e KryetarittëKomitetittëMenaxhimittëZonavetëMbrojturaMjedisore, zhvilloimbledhjen e dytëpërkëtë vit tëkëtijKomiteti. Nëkëtëtakimishte e pranishmeDrejtoresha e Përgjithshme e AgjencisëKombëtaretëZonavetëMbrojtura, Znj. Daniel Pirushi, anëtarët e Komitetit, përfaqësuestë ADZM, sidhepërfaqësuestëinstitucioneveqëlidhen me menaxhimin e zonavetëmbrojturatëQarkutDurrës. Fokusikryesornëkëtëtakimishteprezantimi me risitë e rejaqësjellligji "PërZonat e Mbrojtura", iamenduarnëfillimtëkëtijviti, me

syniminpërtëvendosurnjëekuilibër midis zonavetëmbrojturadhenevojësqëkanëkomunitetetdhepushteti vendor përzhvilliminekonomiktëterritorevetëtyre, sidhepërnjëriformulim e qartësimtëaktivitetevetëlejuaranëkëto zona. Synimiihartimittëinstrumentavetëtillë, ështënxitja e zbatimittëmodelevetëqëndrueshmetëzhvillimitekologjikdheekonomiknëzonat e mbrojtura apo parqetkombëtare, ruajtja e ekosistemitdhediversitetitbiologjik, sidhereduktimiipresionit jo tëqëndrueshëm apo abuzivmbiburimetnatyrore. Ndërtëtjera u bënjëpanoramë e situatësaktuale, puna e bërëgjatë 4- mujorittëparëtëvitit, u diskutuambigjendjen e masavembrojtësedheparandaluese, përsituatat e zjarreve, gjendja e infrastrukturësrrugore, erozioni, aksionet e pastrimitsidherivitalizimiimonumentevetëtrashëgimisëkulturoresiaseteqërrisinatraksionetturistiketëqarkut. Tëpranishmitadresuandisangaproblematikat e konstatuaragjatëpunëssëtyre, përtëcilatPrefektikërkoiangazhimdhebashkëpunimmaksimaltëtëgjithastrukturavedheinstitucionevepërgjegjëse. U caktuandetyratpërkatësepërçdostrukturembimarrjen e masavetënevojshmenëkëtëpragfillimitësezonitveror, me qëllimmbrojtjendherritjen e vleravetëkëtyrezonavetëmbrojtura.

**Mëdatë 17.12.2024**, u mor pjesënëmbledhjen e KomitetittëMenaxhimittëZonavetëMbrojturaTiranë, mbajturnëPrefekturën e QarkuttëTiranës. Nëkëtëtakim u analizuapuna e bërëngaAdministrataRajonale e ZonavetëMbrojturapërvitin 2024, u bëprezantimiiprojektit UNDP në PK Mali iDajtit, prezantimii BE UE4 Nature dheasistencapërmenaxhimin e PK Mali iDajtit. Gjithashtu u diskutuanproblematikatqëkanë Nj. Administrative nëkëto zona, siguria e vizitorëve, çertifikimiishtigjevetëreja, sidhebashkëpunimii ARZM me bashkinëpërguidatturistike.

## III. Marrëdhëniet e Prefektit me Organet e Vetëqeverisjes Vendore.

Në mbështetje të ligjit 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, gjatë vitit 2024në Institucionin e Prefektit kanë hyrë gjithsej254 akte të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore (Këshilli i Qarkut Durrës, Bashkia Durrës, Krujë dhe Shijak), nga të cilat:

Të bazuara në ligj janë 149 akte, të pa bazuara 5akte dhe me karakter individual 100 akte.

**PASTRIMI**

NëzbatimtënismëssëKryeministrittëShqipërisëdheMinistrittëTurizmitdheMjedisitpërzhvillimin e **AksionitKombëtartëPastrimit "Tëçlirojmëterritorinngandotjamjedisore**" InstitucioniiPrefektitpërgjatëvitit 2024 ka ndjekuraksionepastrimidhezhvilluartakimetëvazhdueshme me tëgjithëstrukturattëcilatjanëpjesë e grupevetëpunës, përtëkoordinuardhebashkërenduarpunënsidhepërtuinformuarnëmënyrëperiodikenëlidhje me ecurinë e punësnëdrejtimtëpastrimittëterritorit.Referuarraportimevemujorepërperiudhënnjëvjeçare, nëqarkunDurrësjanëndërmarrëaksionetëshumtanëdrejtimtëpastrimittëterritorit,

kujanëangazhuarstrukturat e NjësivetëVetqeverisjesVendore, Degëtterritoriale, InstitucionetShtetërorenënivel vendor, InstitucionetArsimore, organizatatëndryshme, firmariciklimidhekontribuestëtjerë.

Më poshtë po paraqesim tabelën përmbledhëse e të gjitha aksioneve të pastrimit për vitin 2024 të ndarë në muaj, ku tregohet numri i hotspoteve të pastruara, personat e angazhuar dhe sasia e mbetjeve të evaduara.

| Periudha | Bashkia | Hotspote | Persona tëangazhuar | Volumiimbetjeve (ton) |
|---|---|---|---|---|
| Janar 2024 | Durrës | 5 | 33 | 0.45 |
| | Shijak | 5 | 12 | 12 |
| | Krujë | 6 | 15 | 10 |
| | **Total** | 16 | 60 | 22.45 |
| Shkurt 2024 | Durrës | 9 | 357 | 10 |
| | Shijak | 4 | 19 | 14 |
| | Krujë | 8 | 112 | 16.5 |
| | **Total** | 21 | 488 | 40.5 |
| Mars 2024 | Durrës | 7 | 418 | 218 |
| | Shijak | 15 | 74 | 75 |
| | Krujë | 8 | 142 | 19 |
| | **Total** | 30 | 634 | 312 |
| Prill 2024 | Durrës | 7 | 447 | 26,4 |
| | Shijak | 10 | 46 | 47 |
| | Krujë | 8 | 139 | 18.5 |
| | **Total** | 25 | 632 | 65.5 |
| Maj 2024 | Durrës | 11 | 431 | 59.2 |
| | Shijak | 8 | 51 | 49 |
| | Krujë | 8 | 73 | 18.5 |
| | **Total** | 27 | 555 | 126.7 |
| Qershor 2024 | Durrës | 10 | 93 | 46.5 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Shijak | 7 | 63 | 35 |
| | Krujë | 9 | 47 | 10 |
| | **Total** | 26 | 203 | 91.5 |
| Korrik 2024 | Durrës | 8 | 88 | 46.2 |
| | Shijak | 5 | 53 | 32 |
| | Krujë | 5 | 32 | 8 |
| | **Total** | 18 | 173 | 86.2 |
| Gusht 2024 | Durrës | 14 | 218 | 59.34 |
| | Shijak | 8 | 47 | 27 |
| | Krujë | 9 | 38 | 23 |
| | **Total** | 31 | 303 | 109.34 |
| Shtator 2024 | Durrës | 13 | 185 | 61.1 |
| | Shijak | 11 | 42 | 31 |
| | Krujë | 12 | 35 | 25 |
| | **Total** | 36 | 262 | 117.1 |
| Tetor 2024 | Durrës | 11 | 98 | 73 |
| | Shijak | 8 | 28 | 25 |
| | Krujë | 9 | 40 | 23 |
| | **Total** | 28 | 166 | 121 |
| Nëntor 2024 | Durrës | 14 | 116 | 110.2 |
| | Shijak | 10 | 41 | 32 |
| | Krujë | 12 | 43 | 28 |
| | **Total** | 36 | 200 | 170.2 |
| Dhjetor 2024 | Durrës | 11 | 113 | 100.15 |
| | Shijak | 4 | 44 | 25 |
| | Krujë | 6 | 56 | 33 |
| | **Total** | 21 | 213 | 158.15 |

| TotaliVjetor | | 315 | 3889 | 1420.64 |
|---|---|---|---|---|

Tabela përfundimtare e Aksionit Kombëtar të Pastrimit për vitin 2024 në Qarkun Durrës.

| Viti 2024 | HotSpote | Persona tëangazhuar | Volumiimbetjeve (ton) |
|---|---|---|---|
| Durrës | 120 | 2597 | 784.14 |
| Shijak | 95 | 520 | 404 |
| Krujë | 100 | 772 | 232.5 |
| **Qarku** | **315** | **3889** | **1420.64** |

Si në vitin 2023 ashtu dhe në vitin 2024 ka patur një angazhim nga të gjitha strukturat përgjegjëse në nivel qarku të cilat kanë dhënë kontributin e tyre në pastrimin e territorit. Ky aksion mbarëkombëtar pastrimi ka dhënë impaktin e tij shumë pozitiv, ku tani mbajtja pastër e mjedisit shikohet në një këndvështrim tjetër krahasuar me disa vite më parë edhe pse ka ende punë për të bërë. Gjykojmë që ka ardhur momenti të kalohet në një fazë të dytë të qasjes ndaj mjedisit dhe ndotësve të tij, që përveç formave të tjera të edukimit dhe ndërgjegjësimit, mendojmë që duhet të angazhohen edhe më shumë struktura të tjera ligjzbatuese në identifikimin dhe ndëshkimin e atyre individëve apo subjekteve që ndosin ambjentin në mënyrë të paligjshme dhe padyshim që duhet të jetë prioritet i punës në vitin në vijim.

**INFRASTRUKTURA**

Gjatëvitit 2024 SektoriiZhvillimit Urban i ka kushtuarrëndësitëveçantëinfrastrukturësnënivelqarku, kryesishtinfrastrukturësrrugorenësigurinë e rrugëvenacionaledheatyreruralevendore. Nëkëtëkontekspërgjatëgjithëvititjanëzhvilluartakimetëndryshme me tëgjithëstrukturatpërkatësesidhejanëtrajtuardhendjekurçështjedheproblematikaqëkanëtëbëjnë me infrastrukturënrrugoredhetëgjithëelementët e tyrenëdrejtimtësigurisë.

InstitucioniiPrefektit ka qenënëkomunikimtëvazhdueshëm me OperatorëtEkonomiktëkontraktuarnga ARRSH, përrrugëtnacionaleqëkanënëzotërim, zbatiminsamëkorrektdhepunimesamëcilësorenëkëtoaksebrendaafateveligjoretëpërcaktuara. Nga ana e kontraktorëvepërperiudhënJanar 2024 Janar 2025 ështëpunuarpërmirëmbajtjen e rrjetitrrugor.
Gjithashtunga ana e kontraktorëvejanëmarrë masa tekniko-organizative me qëllimpërballimin e situatësdimëroreNëntor 2024 – Mars 2025 nëndrejtimin e DrejtorisësëRajonitQendërPerëndimTiranë e cilapërfshin;
Ngritjen e shtabitpërorganizimindhedrejtimin e punëvenëlidhje me përballimin e situatësdimërore.
Ndërtimin e skemëssëlajmërimitdhecaktimin e personavepërdhënien e informacionitnëkohëreale.

Marrjen e informacionitngakontraktorët e mirëmbajtjessëakseve, lidhur me gatishmërinë e stafittëtyre, gatishmërinëdheshpërndarjen e mjeteve, sasitë e nevojshmetëmaterialeve, sidhevenddepozitimet e tyre.
InstitucioniiPrefektitgjithashtu ka monitoruarpunën e bashkivedhestrukturavembështetësenëdrejtimtëinfrastrukturësrrugore e mëgjerë, punë e cila ka konsistuarnërehabilitimin e akseverrugore, kuartallave, trotuarevenëlagjetëndryshmetëqyteteve. Janëkryerinvestimenështrimrrugësh me asfalt,rinovimtësinjalistikëshorizontalenërrugët e qyteteve me qëllimrritjen e sigurisëpërkëmbësorët por dhedrejtuesit e mjeteve.Janëkryershërbimetëndryshmenëpastrime, larjetërrugëvedhetrotuareve.
Tëgjithakëtoshërbime, ndërhyrjedheinvestimetregojnëpërnjëvëmëndjetështuartëtëtrebashkivenëQarkunDurrësnëplanifikimin dhealokimin e fondevenëdrejtimtëpërmirësimittëinfrastrukturësrrugore, rritjessëcilësisëdhesigurisëedhepsemundtëthemiqëduhettëbëhetedhemëtepërnëkëtëdrejtimngabashkitë.
Gjatëvitit 2024 nëtakimet e ndryshmeqëPrefektiiQarkut ka zhvilluar me tëgjithëaktorëtpërgjegjësnëdrejtimtëinfrastrukturësrrugorenjëkërkesëspecifike ka qenëedhepërdorimiirrugëve alternative apo dytësore, përtëlehtësuartrafikun e rënduarnëperiudhatëcaktuarakryesishtgjatëperiudhavetëpikuttëqarkullimittëmjetevekumundtëpërmendim: rrugëndytësore Golem-Plepa me kalimnga ana e ShkëmbittëKavajës, e cilaështë e aksesueshmedhe ka lehtësuarshumëqarkulliminnëkëtëzonë; njëtjetërakslehtësuesqëmundtëpërdoretështëedhesegmentirrugorëGjiriiLalëzit-Maminas me kalimngaSukthi.
Njëinvestimirëndësishëmqë po kryhetështëndërtimiidyunazavetërejanëDurrës. Unaza e parë, Spitallë-Currila, me gjatësi 1,7 kilometra do tëlidhëCurrilat me rrugën “Aleksandër Goga” nëpërmjetrrugës “PjetërBogdani”. Unaza e dytë, Spitali – Currila, me gjatësi 1,2 kilometra do tëlidhëCurrilat me rrugën “Aleksandër Goga” nëpërmjetrrugës “IsufFerra”. Fondipërndërtimin e tyreështë 835 milionëlekëpatvsh, me njëafatpunimeshprej 2 vitesh. Këtodyunaza do tëlehtësojnëndjeshëmtrafikunsidhe do tëjapinnjëimpaktpozitivnëzhvillimin e zonaveku po ndërtohen.
Një element irëndësishëmduhettëjetëedhendërgjegjësimi (orientimi) dheinformimiiqytetarëvepërpërdorimin e këtyrerrugëve alternative me qëllimlehtësimin e trafikutnëditëpiku.
Disangaproblematikat e paraqituragjatëvitit 2024 nëdrejtimtëinfrastrukturësrrugorekanëqenënëlidhje me parkimet e gabuara apo abuzimetnëparkingjetpublike, ankesabanorëshpëramortizimerrugëshngamjetet e tonazhittërëndë, shqetësiminngandërhyrjet e vazhdueshmepërriparimedefekteshngastrukturat operative të OSHEE-sëdhe SHRUKD-sëpërtëcilatnukndërhyetmë pas nëmbylljen e tyredheriparimin e asfaltitnëkohë, shqetësimenëlidhje me sigurinërrugoredhesinjalistikënkryesishtnëzonat e banuara, kungaInstitucioniiPrefektitjanëzhvilluartakimepërndërhyrjen e strukturavepërgjegjësenëzgjidhjensamëtëshpejtëtëtyre, gjë e cila ka dhënërezultatet e saj.

RINDËRTIMI

PrefektiiQarkutgjatëkëtijviti ka pasurnëvëmendjeedheproblematikat e dalangatërmetii 26 Nëntorit 2019, kryesishtnëdrejtimtëzonavepërrindërtim, riforcimittëpallatevetëdëmtuara, rikonstruksionittëbanesaveindividualesidhenëdhënien e grantevedhedëmshpërblimevepërtëgjithëbanorëtpërfituespërkategoritë DS1,DS2 dhe DS3.

Gjatëgjithëperiudhës Janar - Dhjetor 2024 nëtëtrebashkitë e qarkut ka vazhduarndërtimiizonavetërejatëbanuaratëcilatnëbashkinëDurrësjanë: Zona 4 Spitallë, Zona 1 Nj. Ad. Manëz, Fshatilalëz Nj. Ad. Ishëm; nëbashkinëShijakështë Zona 1; nëbashkinëKrujëjanë: Zona 1 Nj. Ad. Bupq, Zona 1 Nj. Ad. Thumanë, Zona 1 Nj. Ad Fushë-Krujëdhe Zona 1 bashkiaKrujë.

Nëzonën e Spitallës ka përfunduarndërtimii 996 apartamenteve, kantierimëimadhirindërtimitnë vend. Nëzonën 1 Nj. Ad. Manëz ka përfunduarrindërtimi, kujanëndërtuar 9 pallatetëreja me 226 apartamente.Nëzonën e Ishmit ka përfunduarndërtimii 300 banesavetërejaindividuale. Gjithashtuështëndjekurpunaqë po bëhetpërndërtimin e njëlagjetë re po nëIshëm. Nëkëtëterrenshoqata "RrënjëShqiptare" ka përfunduarndërtimin e 39 shtëpivedheaktualisht po punohetpërndërtimin e tëgjithëinfrastrukturëstëhapësirëspublike (kanalizime, ndriçimi, hapësirat e gjelbëraetj.).

Nëbashkinë e Shijakut ka përfunduarproçesiirindërtimittë 31 pallateve me 665 apartamente.

Ka përfunduarrindërtiminëBupqkujanësistemuarnëapartamentet e tyre 120 familje, kunëqendërtësajjanëndërtuargodina e shërbimevepublike, shkolla e re, palestra sidheamfiteatri.

Po ashtuedhenëThumanë ka përfunduarndërtimii 14 pallateve, 278 apartamentevedhe 155 banesaveindividuale.

Nëzonën e Fushë-Krujës ka përfunduarndërtimii 15 pallateve me 100 apartamentesidhe 167 shtëpiindividuale.

Nëqytetin e Krujës ka përfunduarproçesiirindërtimittë 22 pallateve 5 katëshepër 336 familjet e goditurangatërmeti.

**Rindërtim apo rikonstruksionnë zona tëtjeratëqyteteve.**

GjithashtungaInstitucioniiPrefektitështëndjekurpunaqëështëbërëpërrindërtimin apo rikonstruksionin e pallatevenë zona tëndryshmetëqytetevetëklasifikuar me shkallëdëmtimi DS3, DS4, sidhejanëndjekurshortetëpublikepërndarjen e apartamenteve.

Prefekti i QarkutDurrës ka ndjekurshorteunpublik, ku 135 familjeveiushpërndanëapartamentet e rejatëcilatipërkasinbanesëskolektive nr. 1 dhe 3 Rruga “Lura”, dhe nr. 15 dhe 23 rruga “Ahmet Dakli”, Njësia Administrative nr.5, Durrës. Shorteupublik, ihapurdhe transparent, me objektshpërndarjen e këtyreapartamentevetekqytetarëtqë u janëprishurshtëpitëngatërmeti, u zhvilluanëpranitëfamiljevepërfituese, komisionittëposaçëmdhemediave.
Gjithashtu, po nëBashkinëDurrëspërzonën e lagjiessë re nëSpitallëjanëzhvilluar 4 shortepublikkunëditën e parëtëshorteut 196 familjemorënapartamentet e reja, nëditën e dytëtëshorteutpublikpërfituan 195 familje, nëditën e tretëtëshorteutpërfituan 153 familjedhenëshorteun e katërtpërfituan 20 familje. Shorteu do tëvijojëedhepërtëgjithafamiljet e tjeraqë do tëpërfitojnështëpinëkëtëlagje me 85 pallatedhe 996 apartamente me standartemoderne. Shorteutërësisht transparent zhvillohetnëpranitëkomisionit, familjevepërfituesedhemediave.

**Rindërtimi apo rikonstruksioniishkollavedhekopshteve, qendraveshëndetësore, banesaveindividuale, godinave social - kulturoredhezonave sportive**

Përveçrindërtimittëpallatevedhebanesavetërejapuna e sektorittonë ka qenëedhenëmonitorimin e rindërtimittëshkollavedhekopshteve, qendraveshëndetësore, banesaveindividuale, godinave social-kulturoredhezonave sportive. Mëkryesoretpërmendim:

Gjimnazin "NaimFrashëri", icili po rindërtohet me standardetmëtëmirabashkëkohorepër 750 nxënësdhemësues.

Shkollën e mesmetëbashkuardhekopshtit me tënjëjtinemër “BesnikHidri” nënjësinë administrative Rrashbull, e cila do tëshërbejëpër 460 nxënësdhe 40 fëmijë, tëcilët do tëzhvillojnëproçesinmësimornëkushtebashkëkohore.

Shkollën e mesmetëbashkuardhekopshtin me tënjëjtinemër “RexhepMezini” nëNjësinë Administrative tëIshmit. NdërtimiikësajshkollemundësohetnëpërmjetfinancimittëKfW-Banka GjermanepërZhvillimdhe po zbatohetnga FSHZH. Kjoshkollëqë do tëketë 224 nxënësdhe 35 fëmijëtëkopshtit po ndërtohetsipasstandarteveevropiane. Nga ProgramiiRindërtimitkjonjësi ka përfituar 4 shkollangatëcilat 3 kanëpërfunduar.

Ndërtimin e kopshtittëri "IsufFerra" dherikonstruksionittëpalestrës, punimetëcilatjanëdrejtpërfundimit. Kopshtiiri do tëjetë me 80 fëmijëqë do tëqëndrojnënëambiente me standarteevropianendersa palestra do t’ishërbejë 400 nxënësvetëshkollëssidhekomunitetittëzonës.

Ndërtimin e shkollëssëmesme sportive “BenardinaQerraxhia” dhekonviktittëkësajshkollenëDurrës, financuarnga BE, nëpërmjetprogramit #EU4Schools, zbatuarnga UNDP. Nëpërfundimtëpunësstafipedagogjik, 250 nxënëstëshkollësdhe 150 nxënësqë do tëqëndrojnënëkonvikt do tëjenënëgodinatëreja me kushtedhestandarteevropiane.

Rikonstruksionin total tëshkollës 9 vjeçare “14 Nëntori”, mundësuarngaprogrami #EU4Schools, financuarnga BE dhezbatuarnga UNDP. Nëpërfundimtëpunimeve 700 nxënësdhe 50 fëmijëtëkopshtit me tënjëjtinemër do tëmundtëzhvillojnëproçesinmësimornëambiente me standarteevropiane.

Rikonstruksionin e shkollës 9 vjeçare “Riza Shera” nëRadë, njësia administrative Manëz, e cilamundësohetngaprogrami #EU4Schools, zbatuarnga UNDP dhefinancuarnga BE. Mbasrikonstruksionit, kjoshkollë do tëketëkushtedhestandartebashkëkohorepërnxënësitdhestafinpedagogjik.

Rikonstruksionin total tëshkollës 9-vjeçare “Demokracia”. Kjoshkollë do tëmirëpresë 600 nxënësdhe 40 fëmijëtëkopshtit me tënjëjtinemërnëambientemoderne.

Rikonstruksionin total tëspitalittëKrujës “Dr. Stefan Gjoni”, kuambientet e saj do tëofrojnëshërbimcilësordhekushtebashkëkohorepërnjëpopullsiprej 83 mijëbanorësh.

Rikontruksionin e TeqesësëDollmës e cila u dëmtuarëndëngatërmetiivitit 2019.

Gjithashtu, ngaPrefektiiQarkutDurrësjanëndjekurpërurimetsimëposhtë:

Përururimi i Çerdhes nr. 2 e cila u rikonstruktuatërësishtsipjesë e Programit “EU4Schools” financuarngaBashkimiEvropiandhezbatuarnga UNDP. 120 fëmijët e kësajçerdhejedhestafiprej 17 punonjësishtashmë do tëqëndrojnënëambiente me standartetëlartabashkëkohoredhekushtemoderne. Nëpërurimishintëpranishëmdheambasadorii BE nëTiranë Silvio GonzatosiedhePërfaqësuesja e Përhershme e UNDP nëShqipëri Monica Merino.

Përururimiishkollës 9-vjeçare “EftaliKoçi” e cila u ndërtuatërësisht e re nësajëtëProgramit “EU4Schools” financuarngaBashkimiEvropiandhezbatuarnga UNDP, kuishte e pranishmedheMinistrja e ArsimitdheSportitOgertaManastirliu. Kjoshkollë do tëshërbejëpër 542 nxënës, ndërkohëkopshti me tënjëjtënemër do tishërbejë 40 fëmijëve.

PërurimiiPoliklinikëssëSpecialitetevetëqytetittëDurrësit. Me njërikonstruksiontëplotë, me ambientepritësetëzgjeruara, kushtebashkëkohoredheaparaturatëteknologjisësëfundit, Poliklinika e Specialiteteve do tëofrojëshërbimtëshpejtëdhecilësornë 17 specialitetetëndryshmedheekzaminimelaboratorike.

PërurimiiQendrësRinoreMultifunksionalenëDurrës. KjoQendër ka siqëllimpërmirësimin e infrastrukturësrinorenëpërmjetshtimittëambientevepërlexim (bibliotekë) dhepërzhvillimin e aktiviteverinore me karakteredukativ, kulturor apo social tëkomunitetitrinortëBashkisëDurrës, duke nxiturnjëkohësishtdhendjenjën e vullnetarizmittektërinjtë.

**INVESTIME**

Gjatëkësajperiudhe 1 vjeçare, PrefektiiQarkutDurrës ka ndjekur hap pas hapirealizimin e investimevetëndryshmeqëjanëkryernëQarkun e Durrësit.

Prefekti i QarkutDurrës ka ndjekurpunimetpër:-ndërtimin e godinëssëparkimitpubliknëDurrës me një fond prej 477 milionëlekë.Qendra e re e parkimitnëDurrës do tëketë 400 vendeparkimidhe do tëjetënjëgodinë me funksionetëndërthurura midis hapësiravepërparkim, ambientevepërzyradheaktivitetevetëtjeranënjëhapësirëbashkëkohore.

rikonstruksionin e pishinëspublike "Taq Dafa" tëDurrësit me një fond prej 9 milionëlekë.

restaurimin e ShtëpisësëAleksandërMoisiut (MuzeuEtnografikiDurrësit), sipjesë e programit EU4Culture qëfinancohetngaBashkimiEvropian (BE) dhezbatohetnga UNOPS nëpartneritettëngushtë me Ministrinë e Ekonomisë, KulturësdheInovacionit. Objektiështëklasifikuarsi monument ikategorisësëparëtëshpallurnëvitin 1973, ishquarpërtërësinë e vleraveautentikeqë ka.

rehabilitimin e argjinaturëssëlumitErzennëVadardhë, njësia administrative Sukth. NëVadardhë ka përfunduarrehabilitimii 1 kilometërargjinaturë, 1,8 kilometranëRrushkulldhe 1,7 kilometranëlagjenStalla. Punimenëargjinaturën e lumitErzenjanëkryeredhenëKatundin e Ri nëgjatësi 1,2 kilometra. Përveçrehabilitimittëargjinaturësështëpunuargjithashtu per rehabilitimin e shtratittelumitdhesistemimin e bankinës.

fazën e dytëtëshëtitoressëplazhitnëDurrës. Nëkuadërtëkëtijprojekti ka filluarpunaedhepërrehabilitimin e fasadavetë41 godinaveqëndodhenpërgjatëkësajshëtitoreje. Ky investim ka siqëllimtërehabilitojëfasadat e godinave me elementetermoizoluesepërtërritureficençën e

energjisësiedheqëndrueshmërinë e objektevepërnjëperiudhëafatgjatë duke përmirësuaredheimazhin e tëgjithëkësaj zone bregdetare.

ndërtimin e FakultetittëStudimeveProfesionalenëUniversitetin “AleksandërMosiu” nëDurrës. FalëinvestimittëMinistrisësëArsimitdheSportit do tëngrihetnjëfakultetiri me 45 auditorë, 15 laboratorë, sallakonferencash, terrene sportive dheambientepërstudentëtdhestafinakademik.

ndërtimin e gjimnazittërinëManzë me fondet e bashkisësëDurrësit. Shkolla e re ështëprojektuarpër 324 nxënësdhe do tëjetë me 3 kate, me 9 klasamësimore, 4 laboratore , IT, biologji, kimidhefizikë, bibliotekë , një auditor, palestërtëbrendshmedheterrensportivjashtëdhezonërekreative.

## RIVITALIZIMI DHE VITI I PYJEVE

Gjatëvitit 2024, nëkuadërtëmbrojtjessëmjedisitdheshtimittëhapësiravetëgjelbëranëtëgjithëqarkun e Durrësit, puna e InstitucionittëPrefektitështëfokusuardhenëdrejtimtështimitdhenxitjessërivitalizimit (mbjelljessëpemëve) nganjësitë e vetqeverisjesvendoredhestrukturatpërgjegjësenëkëtëdrejtim.
Prefekti i QarkutDurrës ka ndjekurgjithashtunismën e QeverisëShqiptarepërvitin 2024 si “Viti iPyjeve", lidhur me shtimin e hapsiravetëgjelbërtanëmbështetjetëkësajnisme, apo edhenëdrejtimtështimittëpyjevedhekullotavenëterritoret e NjësivetëVetqeverisjesVendore.
Nëlidhje me këtënismëështëkërkuarnëmënyrëtëvazhdueshmeinformacionipërnumrin e pemëvetPërgjatëvitit 2024nëvëmendjetëInstitucionittëPrefektit ka qenëgjithashtuedhepuna e AdministratëssëZonavetëMbrojturaDurrësnëdrejtimtërivitalizimit.
KështugjatëkëtijvitingaKomitetiiMenaxhimittëzonavetëMbrojturaMjedisorejanëndjekur:
Aktivitetimjedisornëkuadërtëmbrojtjessëmjedisitdheshtimittëhapsiravetëgjelbërta, kustafiiAdZMDurrëssëbashku me nxënësit e shkollës 9-vjeçare Pren Simoni nëDraçDurrëszhvilluannjëorëmjedisore, kunëfokusishtenjohja me rolindherëndësinë e pyjevenëmjedis. Gjithashtunëambientetpërrethshkollës, tëgjithësëbashkubënëtëmundurmbjelljen e rreth 20 fidanëvetujedheselvi.

Aktiviteti mjedisor i zhvilluar nga Stafi i AdZM Durrës në bashkëpunim me nxënësit e shkollës 9 vjeçare “Arbëria” të fshatit Halil në Krujë, ku u mbollën 100 fidanë pishë mesdhetare në zonën e Zgërdheshit, PM Krastë Vrion.

AktivitetimjedisornëkuadërtëDitësNdërkombëtaretëPyjeve, kuAdZMsëbashku me nxënësit e shkollës 9-vjeçare sëfshatitCudhinëKrujë u mbollën 100 fidanëtëllojitpishë e zezënëParkunNatyrortëQafështamës.

Aktivitetimjedisor me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Perlat” Durrës, ku u mbollëndisafidanëullinjnëambjentetpërrethshkollës.

AktivitetimjedisornëkuadërtëDitësBotëroretëDheut, kuAdZMsëbashku me nxënësit e shkollës 9-vjeçare Draç, Durrësmbollënnëambjentetpërrethshkollës 30 fidanëtëllojitpishë e butë, leylanddheulliri.

Aktivitetimjedisor me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Selman Ali Xaka” nëNuajku u mbollën 30 fidanëpyjorënëambjentetpërrethshkollës.

Aktivitetimjedisor me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Arbëria” nëHalilku u mbollën 30 fidanëpyjorënëmjedisetpërrethshkollës.

**NDALIMI I HEDHJES NË TREG DHE PËRDORIMIT TË QESEVE PLASTIKE**

Me Urdhërin e ri të Kryeministrit nr.35, datë 19.02.2024 “Për përbërjen, mënyrën e organizimit dhe funksionimin të Task-Forcës për ndalimin e përdorimit, hedhjes në treg, prodhimit, importimit apo futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të qeseve plastike mbajtëse, si dhe qeseve plastike mbajtëse të oxo-degradueshme dhe oxo-biodegradueshme”, është ngritur Task-Forca e kryesuar nga Zëvendësministri përgjegjës për Mjedisin pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, ku pjesë e saj është dhe Prefekti i Qarkut.
Prefekti i Qarkut Durrës në cilësinë e anëtarit të kësaj Task-Force gjatë kësaj periudhe ka marrë pjesë disa herë në takimet e zhvilluara në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe konkretisht Zvministri i Mjedisit për mbarëvajtjen e punës të kësaj Task-Force, në të cilën janë diskutuar problematika dhe janë ngritur shqetësime të ndryshme.
Gjithashtu Prefekti i Qarkut gjatë vitit 2024 ka zhvilluar takime me strukturat përkatëse pjesë të kësaj Task-Force në nivel qarku, në të cilat janë diskutuar çështje të ndryshme dhe janë ndarë detyra për mirëfunksionimin e grupeve inspektuese.
Konkretisht u miratua kalendari i përbashkët për inspektimin e tregjeve ushqimore dhe industriale në të tre bashkitë e qarkut nga grupet inspektuese ISHMT-ARM-Polici Bashkiake, si dhe u janë lënë detyra konkrete policisë bashkiake të të tre bashkive të qarkut për monitorimin e vazhdueshëm të tyre.
Nisur dhe nga diskutimet e zhvilluara Prefekti i Qarkut ka rekomanduar:
Në rregulloren e funksionimit të tregjeve agroushqimorë dhe industrialë të Bashkive të shtohet si pikë për tu zbatuar dhe mospërdorimi i qeseve të cilat nuk janë konform ligjit Nr. 28/2022 “Për disashtesadhendryshimenëligjin nr. 10 463”, datë 22.9.2011, “Përmenaxhimin e integruartëmbetjeve”, tëndryshuar.
Gjithashtu ndalimi i përdorimit të këtyre qeseve të afishohet në hyrjet e tregjeve si dhe në ambientet e brendshme të tregjeve (këto rregullatëevidentohen me tabelainformuese).

Nëkontratatqëlidhenndërmjetnjësivetëvetqeverisjesvendoredhetregtarëveduhettëvendosetsiklauzolëndalimiipërdorimittëqesevetëcilatnukjanëkonformligjit.

DuhettijepetkompetencëPolicisëBashkiakevendosja e gjobavenërastkonstatimitëpërdorimittëqeseve jo konformligjit.

Tëpërcaktohettarifapërgjobat (përPolicinëBashkiake) ngaMinistriapërShtetindhePushtetin Vendor dhekëtotarifatëjenëtëunifikuarapërtëgjithaBashkitënëpërmjetnjëaktiligjorosenënligjornëzbatimtëVendimit Nr. 367, datë 30.5.2022 “Përpërcaktimin e masavetëhollësishmedheinstitucionevepërgjegjësepërndalimin e përdorimit, hedhjesnëtreg, prodhimit, importimit apo futjesnëterritorin e RepublikëssëShqipërisëtëqeseveplastikembajtëse, sidheqeseveplastikembajtësetë oxo-degradueshme apo oxo-biodegradueshme, nëkuadërtëligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011, “Përmenaxhimin e integruartëmbetjeve”, tëndryshuar.

(GjykojmëqëtarifattëpërcaktohenngaMinistriapërShtetindhePushtetin Vendor me VKM dhe jo ngaKëshillatBashkiakëtëBashkivepikërishtpërunifikimin e tyre.

Institucioni i Prefektit ka kërkuar vazhdimisht dhe në mënyrë periodike, informacione nga të gjithë institucionet përgjegjëse pjesë të Task-Forcës, në lidhje me zbatimin e detyrave, inspektimet e kryera si dhe problematikat e dala, me qëllim koordinimin e punës dhe monitorimin e proçesit për sa i përket qarkut të Durrësit.
Kemi marrë përgjigje nga Policia Bashkiake Krujë, ISHMT, Drejtoria Vendore e Policisë Durrës, Bashkia Shijak dhe nga Drejtoria e Policisë Bashkiake Durrës.
Në përgjigjet e tyre ato shprehen se gjatë kontrolleve që kanë kryer në tregjet apo subjektet përkatëse nuk kanë konstatuar paligjshmëri dhe kanë këshilluar dhe sensibilizuar tregtarët dhe administratorët e tregjeve për mospërdorimin e qeseve jo konform ligjit.
Problematikë mbetet përcaktimi i tarifës së gjobave për Policinë Bashkiake kundrejt përdoruesve të qeseve plastike mbajtëse që janë jashtë kushteve teknike të VKM-së Nr. 367/2022.
Kjo çështje do të vazhdojë të ndiqet në vijimësi nga Prefekti i Qarkut dhe administrata e tij.

## IV. Për urdhërat dhe udhëzimet e nxjerra nga Prefekti.

Në zbatim të ligjit 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" neni 20, gjatë periudhësJanar-Dhjetor 2024 Institucioni i Prefektit ka nxjerrë Urdhëra të ndryshëm me karakter adminisrativ.

### Gjendja Civile.

Në zbatim të Ligjit Nr. 10129, datë 11.05.2009" Për Gjendjen Civile" zyra e arkivit të gjendjes civile ka lëshuar çertifikata të shërbimit të gjendjes civile, duke plotësuar kërkesat e shtetasve .

### Emergjencat Civile

Me qëllim unifikimin e raportimit dhe informacionit vjetor të Prefektit të Qarkut, bazuar në dispozitat e ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" dhe ligjit Nr. 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile",pu ju paraqes informacionin e punës për vitin 2024.
Nisurngapërvoja e deritanishmedheproblematikat e krijuarangaemergjencat civile, kryesishtpërmbytjet, (pasiqarkutDurrësbënpjesëtekzonat me nivelriskutëlartë), sidhe duke vlerësuarrolin e NjësivetëVetqeverisjesVendorenëdrejtimtëmarrjessëmasaveparandaluesendajfatkeqësivenatyrore, pas miratimittë 3 (tre) dokumentavestrategjike, kërkuaminformacionenëlidhje me ecurinë e hartimittëprojekteve, sipasformatittëaplikimittështpallurnëfaqenzyrtaretëMinistrisësëMbrojtjes, nërubrikënnjoftime (meqënëse do tëpranohenvetëmprojektet e përcjelladhetëprotokolluaranëAgjencinëKombëtaretëMbrojtjes Civile derinëdatën 31.01.2024).
Kryerja e investimeve në fushën e mbrojtjes civile bën të mundur minimizimin e riskut, dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe të tjera.

Gjatëmuajitjanar u bërishikiminiplanittëshkallës II-të, “PërreagiminndajndotjevedetarengaHidrokarburetdhelëndëtkimikepërvitin 2024”. Nërishikimin e planit u patënnëvëmendje:

Ndryshimet e ndodhuranëstrukturënpërbërëse, skemën e organizimit, sidhetëlajmërimit;

Ndryshimet e ndodhuranëasetet e nevojshmepërreagimindhedislokimin e tyre;

Ndryshimet e ndodhuranëpersonelinqëaktivizohetnë plan;

Planin e trajnimeve.

Pas përfundimittërifreskimittëplanit, u përcollnëAgjencisëRajonaletëMjedisitTiranë, Durrës, Dibërpërmiratim.

Raste emergjente dhe mbështetje me efektivë të Forcave Xheniere

Si rezultat i rreshjevetëshiutdheborës (nëmalësinë e Krujës) nëdatat 20-22 janar u shfaqënproblematikatëcilat u menaxhuannëkohëngastrukturatpërgjegjëse;

Nëdatën 24 janar, pas njoftimitngaPrefektiiQarkutTiranë se niveliiujitnëUjëmbledhësin e Bovillës ka arriturkuotënprej 317.5m, dhepërpasojë do tëhapet porta e shkarkuesitfundor me qëllimruajtjen e nivelitprej 317.5 m (50 cm nënnivelin normal, përtëkrijuarnjërezervënërastplotash), njoftuamBashkinëKrujëpërmarrjen e masaveparandaluese duke angazhuarstrukturatpërkatësetëkontrollittëterritorit, mbrojtjes civile dhemjedisit. Shkarkimiidetyruar do tëndikojënërritjen e prurjevenëluminIshëm;

Nëdatën 13 shkurt, pas njoftimittëDrejtorisëVendoretëPolicisëDurrëspërkonstatimin e municionittëllojitpredhë e pashpërthyernëzonën e plazhit, kërkuammbështetjen me specialistëtëForcaveXheniere me qëllimeleminimin e rrezikutpërbanorët;

Pas njoftimitnga Salla Operative e DrejtorisëVendoretëPolicisëDurrës, nëdatën 9 mars, mbikonstatimin e 1 (një) municionitëllojitgranatë me 3 (tre) unazanënjëbanesënëSukth, Njësia Administrative Sukth, BashkiaDurrëskërkuamngaAgjenciaKombëtare e Mbrojtjes Civile bashkëpuniminpërtërheqjen e municionitnga ana e specialistëvetëForcaveXheniere me qëllimeleminimin e rrezikut. Nëvendngjarjeshkoimenjëherëpatrulla e policisë e StacionittëPolicisëManzë, e cilavendosiperimetrin e sigurisëderinëardhjen e specialistëvexhenierë;

Si rezultatirreshjevenëdatën 17 prill, u shfaqëndisaproblematikanëBashkinëKrujë, nërrugënKrujë-Qafshtamëpërshkaktërëniessëinerteve u blokuapërdisaorëkalimiimjeteve;

Në datat 4-5 tetor, si pasojë e rreshjeve me intensitet mesatar deri të lartë, u shfaqën disa problematika (kryesisht në Njësitë Administrative Sukth dhe Rajoni Nr. 5, të Bashkisë Durrës) ku në disa banesa, pati prani të ujit në oborre dhe në disa akse rrugore të qytetit pati prani uji por pa pamundësuar aksesin në rrugë (zona nën kuotë);

Si pasojë e rreshjeve me intensitet mesatar deri të lartë, nga data 22-23 nëntor, u shfaqën disa problematika (kryesisht në qytetin e Durrësit) ku në disa rrugë, pati prani të ujit por pa pamundësuar aksesin në rrugë (zona nën kuotë), si dhe nga era me intensitet deri 25m/s pati disa pemë të këputura dhe dëmtim të rrjetit elektrik në 5 fidera të energjisë elektrike (1 në Bashkinë Durrës, 2 në Bashkinë Krujë, 2 në Bashkinë Shijak);

Gjatë datave 14-15 dhjetor si rezultat i rreshjeve me intensitet mesatar deri të lartë (kryesisht në qytetin e Durrësit), u shfaqën disa problematika në disa akse rrugore Rrethrrotullimi i Portit, Rruga e Zjarrfikëseve, Rruga tek Valuta, Kryeqëzimi tek stadiumi "Niko Dovana", shkozet tek ishmagazinat e agroeksportit dhe afër shkollës "Olsi Lasko", Rruga tek Stacioni i Trenit, 2 rrugë në zonën e ishkënetës (2 banesa me prani uji), Rruga e Plazhit (disa bodrume pallatesh), hyrja në Sukth. Në këto zona u punua nga ekipet e M.Z.Sh-së Durrës, Ujësjellës-Kanalizimeve me anë të pompave thithëse me qëllim largimin e ujit;

Pas njoftimitnga Salla Operative e DrejtorisëVendoretëPolicisëDurrës, se mëdatë 18.12.2024, ora 16:40, ështëkonstatuarngaqytetarët (tëcilëtkanënjoftuarshërbimet e PolicisësëShtetit), nënjëbunkier, afër resort "Paila Marine", lagja Nr. 15, Rajoni Nr. 4, BashkiaDurrësmuniciontëllojitpredha (tëpaplasurtëkohëssëluftës). Nëvendngjarjeshkoimenjëherëpatrulla e policisë e KomisariatittëPolicisëDurrës, e cila ka vendosurperimetrin e sigurisë. Me qëllimtërheqjen e municionitdheeleminimin e rrezikut, kërkuammbështetjen me efektivëtëForcaveXheniere;

Nga rreshjet e borës të datës 23 dhjetor në malësinë e Krujës, në aksin rrugor Krujë-Sarisalltik u ndërhy me borëpastruesen e kompanisë që ka në mirmbajtje rrugën në bashkëpunim me bashkinë Krujë (në disa pjesë të rrugës u hodh skorie).

**Trajnime, seminare, stërvitje, takime**

Me qëllimshmangien e çdorrezikutëmundshëmsipasojë e rrëshqitjessëdheutnëskarpatën e jashtmetëdigësnërezervuarin e Rubjekë 1, Njësia Administrative Maminas, pas njoftimittëdatës 25 prillngastrukturatpërgjegjësetëBashkisëShijak, u njoftuamenjëherëKomitetiKombëtariDigavetëMëdha (siautoritetiqëpërmisionndërtëtjeraka,organizimindheushtrimin e kontrollitshtetërormbisigurinë e digave/dambavenëetapat e studim-projektimit, ndërtimit, shfrytëzimitdhemirëmbajtjes, sidhembulimin e problemeveqëlidhen me funksionimin/sigurinë e digave/dambave). Përkëtëqëllim, KomitetiKombëtariDigavetëMëdha**nëdatën 29 prill**thirrinjëtakim me përfaqësuesngaInstitucioniiPrefektitdheBashkiaShijakmbimasatparaprakeqëduhenndërmarrënga ana e BashkisëShijak. Hartimiinjëprojektidhemiratimimë pas nga ana e KomitetitKombëtartëDigavetëMëdhaështëzgjidhja e problematikëstekskarpata e jashtme e digës.

Nëkuadërtëtrajnimevepër 6 (gjashtë) moduletnëfushën e zvogëlimittëriskutngafatkeqësitëdhembrojtjes civile (përgjatë dative 4-5 qershor) tëndërmarrëngaAgjenciaKombëtare e Mbrojtjes Civile (në cilësinë e autoritetit më të lartë koordinues, bashkërendues, drejtues teknik, mbikëqyrës dhe kontrollues në fushën e mbrojtjes civile), me qëllimruajtjendhepërmirësimin e vazhdueshëmtënjohurive, aftësive, kompetencaveprofesionaletëpunonjësvetëinstitucioneveqëndroredhevendore, u përfaqësuam me 2 (dy) punonjësit e sektorit;

**Nëdatën 20.06.2024**, nërajonin e GjirittëDurrësit u zhvilluaStërvitja "Antindotja-2024", sinjëstërvitje e nivelitrajonal JOIN (reagimndajndotjesdetare). Nëstërvitjemorënpjesëinstitucioneqëlegjislacioninëfuqi, nëfushën e mbrojtjesdetarengahidrokarburetingarkon me përgjegjësi: InstitucioniiPrefektit, ForcaDetare,

QëndraNdërinstitucionaleOperacionaleDetare, Drejtoria e PërgjithshmeDetare, AutoritetiPortualDurrës, DrejtoriaVendore e KufiritdheMigracionit, BashkiaDurrës, sidhekompanitë private tëpastrimit. Stërvitjakishtesiqëllimtrajnimin, stërvitjen e efektivavetëanijeve, kryesishttëanijevespecialeantindotjepërpërdorimin e paisjeve, mekanizmave, mjetevedheteknikavetëreagimitndajnjëndotjedetare. Stërvitjetë tilla ndikojnënëpërmirësimin e koordinimit midis institucioneve me interesanë det (nëpërgjigjetënjëemergjence civile ndajnjëndotjedetare) sidhetestimin e kapaciteteveereaguesedetare;

**Në datën 26.06.2024**, në kuadër të monitorimit, koordinimit të stacioneve të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit (në vijim të marrjes së masave për parandalimin dhe përballimin e situatave të pritshme të zjarreve gjatë stinës së verës në sipërfaqet pyjore dhe kullota shtesë lidhur me objektivat e sigurisë nga zjarri në territor) në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit u organizua takimi sensibilizues me strukturat përgjegjëse, me qëllim:

- Rritjen e bashkëpunimit midis strukturave në nivel qarku për përballimin e situatave të zjarreve në pyje gjatë sezonit veror;
- Forcimi i masave parandaluese dhe përballimin e situatave të mundshme të zjarreve në pyje dhe kullota;
- Rritjen dhe forcimin e forcës reaguese, gatishmërisë së punonjësve, automjeteve, mjeteve dhe pajisjeve të ndërhyrjes zjarrfikëse;
- Ngritjen dhe funksionimin e stacioneve provizore zjarrfikëse në zonat turisrike bregdetare, gjatë sezonit turistik.

Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (në cilësinë e një strukture ndërinstitucionale bashkërenduese, që ka detyrë organizimin, planizimin dhe drejtimin e operacioneve detare, në të gjithë hapësirën detare, në përputhje me legjislacionin detar vendas e ndërkombëtar), në kuadrin e planit të trajnimit për vitin 2004, zhvilloi në bashkëpunim të ngushtë me Institucionin e Prefektit, më datë 29.10.2024, në sallën e mbledhjeve të Institucionit të Prefektit, trajnimin me temë: "Plani i masave dhe organizimi i grupeve të punës në terren, për reagimin ndaj ndotjes detare shkalla I dhe II, vlerësimi i derdhjes, si dhe impakti i ndotjes në shëndetin publik". Në trajnim morrën pjesë përfaqësues nga Prefekti i Qarkut Tiranë, Bashkia Durrës, Forca Detare, Drejtoria Vendore e Kufirit dhe Migracionit, Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër, Autoriteti Portual, Romano Port, Porti Multi Buoy Mooring, Kapiteneria,Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetsor.

Në kuadër të fazës së katërt të Projektit "Forcimi i Kapaciteteve për Vlerësimin e Krizave dhe Planifikimin e Rimëkëmbjes" financuar nga Bashkimi Europian, **gjatë datave 19-20 shtator**morrëm pjesë në aktivitetin e Vlerësimit të Nevojave pas Fatkeqësive (PDNA) dhe Zhvillimin e Kornizës së Rimëkëmbjes pas Fatkeqësive (DRF), me qëllim ndihmën e aktorëve kombëtarë dhe rajonalë në përmirësimin e aftësive të tyre për të përgatitur, vlerësuar, planifikuar, zbatuar dhe mbështetur aktivitetet e rimëkëmbjes;

**Nëdatën 30.10.2024**, nëkuadërtëprojektit "FuqizimiiKapacitetevepërVlerësimin e Nevojave pas FatkeqësivedhePërgatitjenpërRimëkëmbje", qëAgjenciaKombëtare e Mbrojtjes Civile po zbaton me UNDP, nëbashkëpunim me BashkiminEuropiandheBankënBotërore, me qëllimrritjen e kapacitetevetëShqipërisënëplanifikimin e rimëkëmbjes pas fatkeqësive, duke përfshirëmësimet e

nxjerrangatërmetii 26.11.2019, ku u aktivizuaMekanizmiiVlerësimittëNevojave pas Fatkeqësisë (PDNA) përvlerësimin e dëmevedhepërgatitjen e planittërimëkëmbjes,uzhvillimuanintervistagjysëmtëstrukturuara me strukturatnënivelqarku/vendor, përtëndarëpërvojëndhenjohuritë e tyrembiproçesin e rimëkëmbjes, me pranitëekspertëvetëAgjencisëKombëtaretëMbrojtjs Civile, UNDP;

Gjatë dative 3-5 dhjetormorrëmpjesënëtrajnimin "FuqizimiimenaxhimittëRiskutngaFatkeqësitënënivel local – Local DRM" me qëllimforcimin e kapacitetevetëmbrojtjes civile nënivelqarku/bashkienëfushën e menaxhimittëriskuttëfatkeqësive.

Mbledhje të Komisionit të Mbrojtjes Civile të Qarkut

Në datën 1 shkurt me objekt: "Analiza e punës së kryer gjatë vitit 2023 në fushën e mbrojtjes civile, si dhe mbi hartimin e dokumentave strategjike";

Në vijim të "Planit të Masave për Sezonin Maj-Shtator 2024" dhe "Plani i Veprimit për Sezonin Maj-Shtatort 2024", me qëllim parandalimin, përballimin, minimizimin e dëmeve që mund të shkaktohen nga fatkeqësitë natyrore dhe të tjera gjatë sezonit të verës, të miratuar nga Prefekti, në datën 13 qershor u thirr mbledhja e Komisionit të Mbrojtjes Civile me objekt: " Marrja e masave për përballimin dhe menaxhimin e situatave të mundshme emergjente gjatë sezonit veror 2024". Marrja e masave do të bëjë të mundur efikasitetin e të gjitha strukturave përgjegjëse, pjesë të Sistemit të Mbrojtjes Civile duke mbrojtur jetën e njerëzve, gjësë së gjallë, pronës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit nga dëmtimi ose rreziku i dëmtimit nga fatkeqësitë;

Në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Mbrojtjes Civile të Qarkut Durrës, nisur nga përvoja e deritanishme, Prefekti në bashkëpunim me Ministrin e Mbrojtjes dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, thirri mbledhjen e rradhës të Komisonit, më datë 25.11.2024, me qëllim diskutimin mbi çështjet/problematikat e mbrojtjes civile, si dhe masat e marra nga strukturat përgjegjëse për përballimin e emergjencave që mund të shkaktohen si pasojë e rreshjeve gjatë sezonit vjeshtë-dimër. Pjesëmarrës në takim ishin Ministri i Mbrojtjes Z. Pirro Vengu, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile z. Haki Çako, Kryetarja e Bashkisë Durrës Znj. Emiriana Sako, Kryetari i Bashkisë Shijak Z. Elton Arbana, Nënkryetari i Bashkisë Krujë Z. Ilir Loci, Drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë Z. Skënder Hitaj dhe Drejtues të Agjencisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Durrës, OSSHEE, Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit, Administrata e Zonave të Mbrojtura, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetsor dhe strukturat përgjegjëse vendore.Prefekti, pasi paraqiti një panoramë të situatës në fushën e mbrojtjes civile, si për sezonin veror dhe sezonin e rreshjeve, vlerësoi nismën e ndërmarrë nga Ministri i Mbrojtjes, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile në kuadër të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë. Investimet në fushën e mbrojtjes civile do të bëjë të mundur rritjen e efektivitetit të të gjitha strukturave në përballimin, minimizimin e situatave emergjente. Në fjalën e tij Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, shpjegoi 3 (tre) thirrjet për projektet, konkretisht:

Investimet në infrastrukturë;

Rehabilitimi i digave të rezervuarëve;

Blerje mjetesh, pajisjeshnëkuadërtëfuqizimittëkapaciteteve.

Mbledhje të tjera për çështje në fushën e mbrojtjes civile

Mëdatë 08.07.2024, nëvijimtë "Planit tëMasavepërSezonin Maj-Shtator 2024" dhe "PlaniiVeprimitpërSezonin Maj-Shtatort 2024", me qëllimparandalimin, përballimin, minimizimin e dëmeveqëmundtëshkaktohenngafatkeqësitënatyroredhetëtjeragjatësezonittëverës, tëmiratuarngaPrefekti, me ftesë të Bashkisë Krujë morrëm pjesë në mbledhjen e Komisionit të Mbrojtjes Civile në Nivel Vendor me objekt: "Marrja e masave për përballimin dhe menaxhimin e situatave të mundshme emergjente gjatë sezonit veror 2024". Marrja e masave do tëbëjëtëmundurefikasitetin e tëgjithastrukturavepërgjegjëse, pjesëtëSistemittëMbrojtjes Civile duke mbrojturjetën e njerëzve, gjësësëgjallë, pronës, trashëgimisëkulturoredhemjedisitngadëmtimioserrezikuidëmtimitngafatkeqësitë;

Më datë 15.07.2024, në vijim të krijimit të strukturës së përkohshme të "Trupës së Ndërhyrjes Teknike", pjesë e së cilës është dhe Drejtoria Vendore e Policisë Durrës për plazhin e Gjirit të Lalzit; "Planit të masave dhe veprimit gjatë sezonit veror 2024" të miratuar nga Prefekti; urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Durrës "Për ngritjen e stacionit të përkohshëm të M.Z.Sh-së për sezonin e verës në zonën turistike të Gjirit të Lalzit"; si dhe masave shtesë me qëllim reagimin në kohë të forcave zjarrfikëse gjatë situatave të mundshme emergjente përgjatë sezonit veror, u mbajt një takim në ambientet ku do ofrojnë shërbim 24 orë: forcat zjarrfikëse, efektivët e Policisë së Shtetit dhe Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetsor. Në takim morrën pjesë Shefi i Rendit pranë Drejtorisë Vendore të Policisë, Drejtoresha e Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetsor, Drejtori i M.Z.SH-së Durrës, staf (mjekësor, zjarrfikës, policie). Stacionimi i një mjeti zjarrfikës në zonën e Gjirit të Lalzit (e pasur me zonë pyjore, në një distancë të konsiderueshme nga reparti zjarrfikës në Durrës, nivelit të lartë të riskut) do të bëjë të mundur reagimin në kohë të ndonjë zjarri të mundshëm;

Nëkuadërtëbashkëpunimit midis MinistrisësëBrendshmedheInstitucionevetëPrefektëve, nëdatën 07.11.2024 u mbajttakimiiMinistrittëBrendshëm Z. Ervin Hoxha me Prefektët, sidhe me pjesëmarrjen e Zv. KryeministresdheMinistressëEnergjitikësdheInfrastrukturësZnj. Belinda Balluku. Njëngaçështjet e rendittëditësishte "Siguria e Digave". Nga analiza e raportevetëshfrytëzimittëdigave, tëpërcjellangabashkitë, rezultojnënjësërëproblematikash, tëpërcjellaedhengaKomitetiKombëtariDigavetëMëdha (në cilësinë e institucionit që ushtron kontrollin e shtetit për sigurinë e digave si vepra të një rëndësie të veçantë, si dhe miratimin e projekteve të zbatimit për rehabilitimin e digave që janë në shfrytëzim). Duke pasur parasysh faktin që digat janë objekte të rëndësisë së veçantë dhe për rrjedhojë shfrytëzuesit e tyre duhet të marrin masat për sigurinë e digave dhe njerëzve në zonat urbane që ndodhen poshtë tyre, në koordinim me Kryetarin e Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha (në cilësinë e institucionit që ushtron kontrollin e shtetit për sigurinë e digave si vepra të një rëndësie të veçantë, si dhe miratimin e projekteve të zbatimit për rehabilitimin e digave që janë në shfrytëzim) Prefekti thirri në një takim në datën 20.11.2024, strukturat përgjegjëse vendore pranë 3 Bashkive (që kanë në administrim digat dhe rezervuarët), për të diskutuar mbi problematikat e dala nga analiza e raporteve tëshfrytëzimittëdigave, tëpërcjellangaNjësitë e VetqeverisjesVendore (në cilësinë e institucionit që ushtron kontrollin e shtetit për sigurinë e digave si vepra të një rëndësie të veçantë, si dhe miratimin e projekteve të zbatimit për rehabilitimin e digave që janë në shfrytëzim). Përsa i përket, sistemeve të alarmit dhe monitorimit (përcjellin sinjalin e rrezikut), përbën çështje urgjente. Në qarkun Durrës 6 (gjashtë) janë digat të cilat

nuk janë të pajisura me sisteme alarmi dhe monitorimi (Rubjek, Çallik, Metallë, Xhafzotaj, Tarin, Topana). Këto diga kanë edhe nivelin më të lartë të riskut për shkak se poshtë tyre ka zona urbane. Pë shkak të numrit të lartë të rezervuarëve që ka në administrim Bashkia Durrës, pas ndryshimit të buxhetit të vitit 2024, gjatë muajit nëntor është nënshkruar kontrata me operatorin ekonomik fitues për projektet e 5 (pesë) digave (Topana, Ishëm, Spitallë 1, Rromanat, Memaj). Në lidhje me pasaportën e digave, pavarsisht mungesës së projekteve të digave, si dhe përpjekjeve të vazhdueshme nga strukturat përgjegjëse për gjetjen së tyre pranë QëndrëssëTransferimittëTeknologjiveBujqësoreFushëKrujë (nëkëtëqëndërvetëmpërnjëpjesëtëdigavejanëgjeturprojektet), formulariipasaportëssëdigës (sipasformatittëpublikuarnëfaqenzyrtaretëKomitetitKombëtartëDigavetëMëdha) ështëplotësuarvetëm me tëdhënat e disponueshmenga ana e strukturavepërgjegjësevendore. Mbetetnjëproblematikë e trashëguarqëngatransferimiidigavengaMinistria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dheAdministrimittëUjëravetekBashkitë;

Nëdatat 18-19 dhjetornëkuadërtëprezantimit, informimitdhebashkërendimitmbisistemin e mbrojtjes civile nëqarkunDurrës u mbajtëntakimenëInstitucionin e Prefektit/Bashkitë me Drejtorin e QëndrëssëMbrojtjes Civile Tiranë, Durrës, Dibër me fokusnëpërgatitjen e “Planevetëmasavepërsezonindimëror”, gjendjen e gatishmërisësëmjeteve, materialevedhepersonelitqëangazhohetnëpërballimin e situataveemergjente, ecuria e përgatitjessëdokumentavestrategjikenënivel vendor.

Investime në fushën e mbrojtjes civile

Në kuadër të zbatimit të VKM-së Nr. 306, datë 22.05.2024 “Për miratimin e projekteve fituese të financuara për vitin 2024 nga Fondi për Digat, si dhe Autoritetit Kontraktor për zbatimin e projekteve, sipas Njësive të Vetqeverisjes Vendore”, ku pjesë e listës është dhe projekti i Bashkisë Shijak “Rehabilitim i rezervuarit të digës Bilalaj”, pas miratimit të projektit nga Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (në cilësinë e institucionit që ushtron kontrollin e shtetit për sigurinë e digave si vepra të një rëndësie të veçantë, si dhe miratimin e projekteve të zbatimit për rehabilitimin e digave që janë në shfrytëzim) është firmosur kontrata me operatorin ekeonomik fitues;

Në zbatim të VKM-së Nr. 260, datë 27.04.2023 “Për miratimin e listës së projekteve fituese të financuara nga “FondipërParandalimindheMenaxhimin e FatkeqësiveNatyrore”, kupjesë e listësjanëdheprojektet e hartuaranga BashkiaDurrësdheBashkiaKrujë, konkretisht:

BashkiaDurrës - Përforcimterreningarrëshqitjanëzonën e NjA-ve nr.2, nr.4, Ishëm;

BashkiaKrujë - Punimepërrehabilitimin e shkarkuesit, Rezervuari “Vrijon” dhesistemimipërroitlagja nr. 3, Kova

Punimet për të dyja projektet kanë përfunduar;

Me qëllimforcimin e kapacitetevenëmjetepërpërballimin e emergjencavegjatësezonittëzjarreve, M.Z.Sh-ja Durrësmorri 1 mjetzjarrfikëspikup;

Ka përfunduar ndërhyrja në projektin “Sistemim i përroit të Gjepalës dhe i përroit nga pallati i Jasharëve deri në lumin Erzen me gjatësi 365ml” me bashkëfinancim të të ardhurave të bashkisë dhe fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile për vitin 2024.

Përdorimi i Fondit të Kushtëzuar për mbrojtjen civile

| INSTITUCIONI | FONDI I ARDHUR | SHUMA E LËVRUAR | VENDIM I KËSHILLIT BASHKIAK | FONDI I PËRDORUR | FONDI I PAPËRDORUR |
|---|---|---|---|---|---|
| BashkiaDurrës | 38,955,455 | 5,829,106<br><br>4,133,471 | VKB-ja Nr. 58, datë 25.06.2024; VKB-ja Nr. 107, datë 16.12.2024 | 9,962,577 | 28,992,878 |
| BashkiaShijak | 5,321,474 | 5,321,474 | VKB-ja Nr. 19, datë 03.06.2024 | 5,321,474 | 0 |
| BashkiaKrujë | 8,641,191 | 641,372<br><br>536,652.55<br><br>399,122.8<br><br>657,587.25 | VKB-ja Nr. 86 datë 22.12.2023; VKB-ja Nr. 16, datë 12.04.2024 VKB-ja Nr. 67, datë 06.12.2024 VKB-ja Nr. 82, datë 26.12.2024 | 2,234,734.6 | 6,406,456.4 |
| Totali | 52,918,120 | 17,518,785.6 | 7 - VKB | 17,518,785.6 | 35,399,334.4 |

Sektori i Financës dhe i Shërbimeve Mbështetëse

Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, pranë Prefektit tëQarkut Durrës, gjatëvitit 2024 e kambështeturpunën e sajnëzbatim të ligjshmërisë dhe objektivave të shtruara për realizimin e tyre në të gjithë veprimtarinë e këtij sektori, në zbatim të ligjit "Për Prefektin e Qarkut", të ligjit "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" si dhe ligjeve e udhëzimeve specifike në fushën e financës.

Në zbatim të saj kemi patur bashkëpunim dhe me sektorët e tjerë të Prefekturës si dhe në kontakt e ndjekje të vazhdueshme dhe me njesitë e qeverisjes vendore në zbatim të kërkesave të reja të menaxhimit dhe efikasistetit më të mirë të burimeve financiare të vëna në dispozicion nga ana e buxhetit të shtetit. Ne këtë periudhë, detyrat para punonjësve të Sektorit të Financës ishin në realizimin me efikasitet dhe kopetencë profesionale të gjithë aktivitetit të tyre.

Sektori Financës që në fillim të vitit në bashkëpunim me sektorët përkatës të Prefektit Qarkut Durrës, bëri detajimin e buxhetit të vitit 2024 si dhe dha ndihmën parësore për tre Bashkitë, me qëllim që detajimi dhe vënia në zbatim e këtij buxheti të bëheshin saktësisht dhe në kohë. Kjo është kryer si me detajimet buxhetore, paketat fiskale, mbylljet vjetore apo ndjekjen e problematikave që shfaqeshin vazhdimisht në këto njësi.

Po në këtë këndvështrim u punua dhe u krye mbyllja e rezultatit ekonomik të Prefekturës si dhe u hartua programi vjetor i punës për vitin 2024. Brenda muajit Janar 2024, u detajua buxheti i ri për vitin 2024 për administratën e Prefektit dhe Gjendjen Civile. Gjithashtu u hartua Rregjistri i

realizimit të Prokurimit Publik për vitin 2023 si dhe u hartua dhe miratua nga Agjensia e Prokutimit Publik, Rregjistri i parashikimit të Prokurimit Publik për vitin 2024 të cilët u dërguan brenda afatit në Ministrinë e Brendshme dhe Degën e Thesarit.

NëzbatimtëUrdhërit nr.7 protdatë 12.01.2024 dheUrdhërit nr.45 protdatë 17.07.2024 tëPrefektittëQarkut Durrës ështëpërcaktuarstruktura e administratëssëPrefektit me 28 punonjës, (bashkë me 2 punonjëstëgjendjescivile) sipas pozicionevetëpunësdhe me emrat e punonjësve. Nga DAP janëhapurproçeduratnëmuajinnëntor 2024 për 1 Përgjegjësesi i SektorittëPlanifikimitdhePërballimittëEmergjecave Civile dhe 2 specialistnëSektorinMonitorimittëKopetencaveVendoredheFunksionevetëDeleguara, tëcilatjanënëproces. Gjatëgjithëkësajperiudhekanëqenënëmarrëdhënie pune mesatarisht 25 punonjës, për të cilët janë kryer në afat hartimi i listpagesave, përllogaritja e kontributeve dhe tatimit, përpilimi i urdhër shpenzimeve si dhe ndjekja e pagesave në Thesar dhe Bankë.

Gjatë këtij viti, Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në zbatim të ligjit nr.97/2023 “Për Buxhetin e vitit 2024”, të Udhëzimit Plotësues nr.1 datë 24.01.2024 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”, ka ndjekur përdorimin dhe administrimin e fondeve të vëna në dispozicion për aparatin e Prefekturës dhe atë të Gjendjes Civile. Kemi raportuar çdo muaj, evidencat e realizimit të treguesve buxhetorë në Ministrinë e Brendshme dhe në Degën e Thesarit.

Në buxhetin e vitit 2024, në total ku përfshihet Prefektura dhe Gjendja Civile, gjithsej janë 42,518.2 mijë lekë, ku peshën më të madhe e zënë shpenzimet për paga të personelit në masën 31,206 mijë lekë ose 73,5 % të totalit, kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore 5,355 mijë lekë ose 12,5 % të totalit, shpenzimet për mallra e shërbime 5,927 mijë lekë ose 13,9% të totalit.

Sipas zërave përkatës shohim që pagesat për personelin u realizuan 96 % ose 2.466 mije lekë më pak, kjo ka ardhur si rezultat i tre vendeve vakant të plotësuara gjithë vitin dhe nji me raporta lindje. Për kontribute per sigurime shoqerore e shendetesore u realizuan 93.% ose 381 mije lekë më pak. Për mallra e shërbime të tjera realizimi ishte në masën 83.%. % ose më pak 991 mijë lekë. Transferta per buxhet familjar e individet realizuar 100 %, ne masën 30 mijë lekë.

Detyra kryesore e punës së institucionit të Prefektit është menaxhimi sa më racional i këtyre fondeve. Në vitin 2024 realizimi i fondeve buxhetore është në masën 94.2 %, ose nga 42.518 mijë lekë të planifikuara në fakt janë shpenzuar 40.052 mijë lekë, më pak 2.466 mijë lekë. Sipas zërave përkatës, pagesat për personelin u realizuan 96 % ose 1.093 mije lekë më pak, kjo ka ardhur si rezultat i tre vendeve vakant të plotësuara gjithë vitin dhe nji me raporta lindje. Për kontribute per sigurime shoqerore e shendetesore u realizuan 93.% ose 381 mije lekë më pak. Për mallra e shërbime të tjera realizimi ishte në masën 83.%. % ose më pak 991 mijë lekë. Transferta per buxhet familjar e individet realizuar 100 %, ne masën 30 mijë lekë.

Gjatë këtij viti së bashku me komisionet përkatëse (komisioni i testimit, prokurimit dhe ai i marrjes në dorëzim), janë realizuar 14 proçedura prokurimi me vlerë të vogël, nga 15 të planifikuara. E shprehur në vlerë monetare nga 2,378,290 lekë pa tvsh i përcaktuar fondi limit është realizuar 1,519,622 lekë pa tvsh. Nga proçedurat e parealizuara është vetëm ai për shpenzime për të tjera materiale dhe shërbime operative pasi nuk u nevojit që të kryhet. Gjithashtu është dërguar në APP Regjistri i realizimit të proçedurave të prokurimit publik për çdo katër mujor si dhe ai vjetor.

Është realizuar mbajtja e sistemit të kontabilitetit të vlerave monetare dhe materiale, lëvizja e aktiveve, raportim për vendimmarrjen në funksion të realizimit të objektivave, përgatitja e pasqyrave financiare të institucionit dhe depozitimi në degën e thesarit dhe Ministrinë e Brendshme.

Eshte bere shpallja e vendeve te punonjesve me status nenpunesi ne sistemin HRMIS sipas kritereve te kerkuara ne zbatim te Ligjit 152/2013"Per statusin e nenpunesit civil" për -3 pozicione; nga keto 2 kategori ekzekutive+1 drejtues i ulet.
Është bërë hedhja e të dhënave të dosjeve individuale në këtë sistem dhe po punohet akoma për pasqyrimin e pervojës së punës duke ndjekur trajnime periodike pranë shkollës ASPA.
U krye raportimi vjetor i nevojave për rekrutim në Ministrinë e Brendshme, si dhe gjendja mbi zbatimin e Ligjit 152/2013"Për statusin e nënpunësit civil" tek Komisioneri për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil.
Jane nxjerre urdhërat per 2 automjetet ne dispozicion te administrates se Prefektit duke zbatuar Urdhrin e Ministrit te Brendshem nr.112,dt.18.04.2014 "Per percaktimin e numrit te automjeteve dhe shofereve si dhe disa rregulla per perdorimin e tyre", ne zbatim te tij eshte bere dhe plotesimi ditor i flete-autorizimeve te punonjesve te administrates, si dhe plotesimi mujor i flete-udhetimeve te shofereve te automjeteve.
Nga ana e Arkiv-Protokollit jane ka kryer çdo dite te gjitha veprimet per pranimin, rregjistrimin, ciklimin dhe shperndarjen e korespondences ne baze te Ligjit nr.9154 te vitit 2003 "Per fondin arkivor kombetar dhe per arkivat" si dhe rregullave te percaktuara ne rregulloren e Prefektit.
Eshte mbajtur protokoll ne te gjitha mbledhjet, takimet apo rastet e emergjences te organizuara nga Prefekti. Ështembajturprotokoll per tegjithambledhjet e KeshillitteBasenitUjor.
Është kryer menaxhimi dhe administrimi i faqes zyrtare të Prefekturës. Ku janë realizuar aktivitete dhe takime të ndryshme, të cilat janë publikuar si në faqen zyrtare dhe në rrjetet sociale.

**Raportime të veçanta.**

**Me datë 17.04.2024**Prefekti i QarkutDurrës Z. Emiljan Jani patikënaqësinëtëpristenënjëtakimzyrtarKryetarin e BashkisësëTuzlësnëBosnjeHercegovinë Z. ZijadLlugaviqsidhedelegacioninqë e shoqëronteatë. GjatëkëtijtakimiPrefektiinformojKryetarin e Bashkisëpërresursetekonomiketë QarkutDurrës, prioritetet e zhvillimitekonomik, projektet e rëndësishmeqë po transformojnëqarkuntonëdhemundësitë e shansetpërbashkëpunimkreativ me

interesreciprok. U biseduapërvleratqëlidhin e bashkojnëdypopujttanë, sidhe u identifikuanfushatëndërsjelltabashkëpuniminëfushën e arsimit, ekonomisë, turizmit e trashëgimisëkulturore. Nëkëtëtakimtërëndësishëm u prezantuagjithashtuQarkuiDurrësit, resursetturistike, bregdetiimrekullueshëm, trashëgimia e pasurhistorikekulturore e qarkuttonësiedheprojektet e mëdhaqë po zhvillohen e që po e kthejnëDurrësinnënjëdestinacionturistikeuropian. Nëtakimpalëtgjithashtubashkëbiseduanlidhur me vendosjen e partneritetitpërbinjakëzimin me Bashkinë e Tuzlësnisuredhengangjashmëritë midis dyqytetevetonapërçuarpërparavazhdimin e bashkëpunimitnëfushat e interesittëpërbashkët, siturizmi, kultura apo zhvillimi urban.

**Me datë 19 .04.2024**PrefektiiQarkutDurrës Z. Emiljan Jani ishteipranishëmnëceremoninë e dorëzmittë, titullit “QytetarNderiiDurrësit” (pas vdekjes) familjarëvetënjëprejfiguravemëtëshquaratëartitshqiptar, MirushKabashi. Nëkëtëaktivitettëorganizuarnënkujdesin e KryetaressëBashkisëDurrësZnj.EmirianaSako, merrninpjesëpersonalitetetëartit e kulturës, miq e kolegëtëaktorittëmadh, tëcilëtpërkujtuanartistindheintelektualin me njëbagazhtëpasurkulturor, njëngainterpretuesitmëtëmëdhenjtëpoezisënëShqipëri, njëpersonalitetishquaricilibënpjesënëplejadën e artistëvemëtëmëdhenjkombëtarë. Figuratë tilla ijapinvlerëtëmadheqytetittonëdhetëgjithëkombitshqiptardheata do tënderohendherespektohenmaksimalishtpërkontributin e tyre.

**Mëdatë 10.05.2024**PrefektiiQarkutDurrës Z. Emiljan Jani pritinënjëtakimNënkryetarin e BashkisësëXhenovës Z. Pietro Piciocchiicilierdhipërnjëvizitëzyrtarenëqytetin e DurrësitnëkuadërtëDitëssëEvropës. Nëtakimin e zhvilluarPrefektivlerësoimaksimalishtkontributindhembështetjenqëShteti Italian ka dhënëndërvite, sidhemarrëdhëniet e veçantaqëekzistojnëmesdyvendevetona, tëcilatnxisinforcimin e bashkëpunimitnëfusha me interestëndërsjelltë. GjatëkëtijtakimiPrefektiiQarkutnjohu Z. Piciocchi me rolin, funksionet, veprimtarinë e InstitucionittëPrefektitsidhe me potencialin e jashtëzakonshëmekonomik, turistik, dhe me trashëgiminëkulturoretëQarkuttonë. Ndërtëtjera u diskutuambirëndësinëqë ka forcimiibashkëpunimitnëfushën e arsimit, turizmit, ekonomisësidhenëfushën e marrëdhënieveinstitucionale. Palëtshprehëngatishmëritëplotëpërtëkonkretizuardhethelluarmëtejshkëmbimetkulturore-njerëzoredhepërtërealizuarmësuksesçdoiniciative apo marëveshjeqë do tishërbejëdyvendevetona.

**Me datë 16 .11.2024**PrefektiiQarkutDurrës Z. Emiljan Jani ishteipranishëmnëceremoninësolemnetëorganizuarngaBashkiaShijak me rastin e 80-vjetorit tëçlirimitngapushtuesitnazifashistë. KryetariiBashkisëShijak Z. Elton Arbana, deputetë, veteranëtëLuftës Nacional Çlirimtarenëkëtë 16 Nëntorpërkujtuan 80-vjetorin e çlirimittëShijakutngaokupatorifashist. Prefektinëfjalën e tijshprehunderimdhemirënjohjepërdëshmorët e rënënëluftënpërçlirim. Kjoditëduhetkonsideruarsishëmbullqytetariedhepërgjegjësiepërtëgjithë ne, mjaftontëshohim pas nëvitepërtëkuptuarsfidat e kaluarapërtëpaturnjë vend tëlirëdhetëbegatë. Pas 80 viteshjemikrenarëpërqëndresëndheluftën anti fashistedhe sot e përkujtojmëkëtëditëhistoriketë 16

Nëntorit me respektindhemirënjohjenmëtëmadhepërdëshmorët e Shijakuttëcilëtsakrifikuanjetët e tyrepërçlirimin e këtijqytetitëvogël, por plot vlerahistorikedhemikpritje.

**Me datë 20 .11.2024** Prefekti i Qarkut Durrës Z. Emiljan Jani dhe Sekretari i Përgjithshëm Z. Edison Jonuzi morën pjesë në ceremoninë solemne të organizuar nga Bashkia Durrës në lapidarin simbol të kësaj dite, në përkujtim të "81-vjetorit të evakuimit të gjithë atyre të rinjve luftëtarë patriotë që u internuan në kampet e përqëndrimit nga nazistët gjatë luftës së dytë botërore". 20 Nëntoriivitit 1943 ështënjëditëhistorike, njëngamomentetkursecilipre j nesh duhettëreflektojëmbitëshkuarëndhetëardhmen, mbipërpjekjetdhesakrificatnjerëzorederinëhumbjen e jetësnëemërtënjëkauzetëmadhe, nëemërtëlirisësëatdheut.
Mirënjohjedherespektpërtëgjithëatatërinjqëbënërezistencëantifashistedhevuajtënnëburgjetdhekampet e përqëndrimitnazist!

**Me datë 26.11.2024** Prefekti i Qarkut Durrës Z. Emiljan Jani ishte i pranishëm në ceremoninë solemne në përkujtim të 26 Nëntorit 1912, ditës së ngritjes flamurit të pavarësisë në Durrës. Në prani të deputetëve të qarkut, veteranëve, përfaqësuesve të komuniteteve fetare, qytetarëve të Durrësit, Kryetarja e Bashkisë Durrës Znj. Emiriana Sako ngriti flamurin kuq e zi.

**Legalizimi i dokumentave.**

Bazuar në VKM Nr.134 datë 07.03.2003 "Për vërtetimin dhe legalizimin e dokumentave të lëshuara në Republikën e Shqipërisë për përdorim jashtë vendit dhe të dokumentave të huaja për përdorim brenda vendit" janë legalizuar **1268** dokumenta të lëshuara nga organet e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.

**Shqyrtimi i kundravajtjeve administrative në fushën e qarkullimit rrugor.**

Në lidhje me kundravajtjet administrative, në zbatim të Udhëzimit Nr.687 datë 05.12.2013 "Për mënyrën e evidentimit dhe shqyrtimit të kundravajtjeve administrative, proçedurat që ndiqen për masat administrative plotësuese dhe administrimi i gjobave në fushën e qarkullimit rrugor" janë shqyrtuar 10 praktika shkresore të dërguara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Durrës.

**PREFEKTI**

**EMILIAN JANI**

**Konceptoi:**A.Murto
**Pranoi:** E. Çato

**Konfirmoi:** S.Zeqja
V.Rustani
L.Zeka
R.Metanj
D.Polena

**Miratoi:**
**Sekretari Përgjithshëm**
**Edison Jonuzi**

**PREFEKTI I QARKUT DURRËS**

**EVIDENCË PËR AKTET NORMATIVE TË ORGANEVE TËVETËQEVERISJES VENDORE**

**Janar -Dhjetor2024**

| | | VerifikimiiLigjshmërisësëAktevetëOrganevetëVetëqeverisjesVendore | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **AktetëhyratekPrefekti** | | **Tëbazuaranëligj** | | **Tëpabazuaranëligj** | | **Me kara individ** | |
| **Nr.** | **Njësitëvetëqeverisjesvendore** | Muj. | Prog. | Muj. | Prog | Muj. | Prog. | Muj. | P |
| 1 | Këshilli i QarkutDurrës | 0 | 21 | 0 | 15 | 0 | 0 | 0 | |
| 2 | BashkiaDurrës | 0 | 119 | 0 | 64 | 0 | 0 | 0 | |
| 3 | BashkiaKrujë | 0 | 82 | 0 | 40 | 0 | 5 | 0 | |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | BashkiaShijak | 0 | 32 | 0 | 30 | 0 | 0 | 0 |
| **Shuma** | | **0** | **254** | **0** | **149** | **0** | **5** | **0** |